



safejournalists.net

# SHQIPËRI Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2022





**SHQIPËRI**  
**Treguesit e Nivelit**  
**të Lirisë së Mediave**  
**dhe Sigurisë së**  
**Gazetarëve në**  
**Shqipëri 2022**

**Autor**  
**Blerjana Bino**

## Titull në origjinal

Shqipëri – Indicators on the Level of Media Freedom and Journalists' Safety Albania 2022

## Botues

Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë  
Tiranë, 2023

## Autor

Blerjana Bino

## Proofreading

Durim Tabaku

## Redaktorë

Kristina Voko  
Erida Skëndaj

## Përkthimi

Durim Tabaku

## Fotoja e kopertinës

Andrija Vukelic

## Realizimi grafik

comma.rs

## Tirazhi

50

Ky botim u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autores dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Fondit Ballkanik për Demokraci, Balkan Trust for Democracy, dhe German Marshall Fund të Shteteve të Bashkuara apo partnerëve të tyre.



 **Norway**

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

# Tabela e përmbajtjes

<b>Hyrje</b>	<b>7</b>	B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik	28
<b>A Mbrojtja ligjore</b>	<b>11</b>	B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse	29
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimimi i tyre në praktikë	11	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	29
A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	16	B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	31
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	17	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>32</b>
A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve	18	C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë	32
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	21	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve	35
A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	21	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve	37
<b>B Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve</b>	<b>25</b>	<b>Përfundimet dhe rekomandimet</b>	<b>40</b>
B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	25	PËRFUNDIME	40
B2 Pavarësia editoriale në mediat private	27	REKOMANDIME	41

# Përmbledhja dhe qëllimi i projektit

Me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar një platformë të përbashkët [Safejournalists.net](https://safejournalists.net) për të monitoruar ndryshimet në legjislationin dhe praktikën e vendeve të tyre dhe për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme advokimi që synojnë përmirësimin e mjedisit politik, legjislativ dhe institucional në të cilën punojnë gazetarët dhe mediat. Duke filluar nga viti 2020, anëtarët e platformës kanë monitoruar situatën në shtatë shtete (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal i Zi, Kosovë<sup>2</sup> dhe Serbi). Çdo vit bëhet një vlerësim i situatës në bazë të metodave të standardizuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave<sup>3</sup>, ndërkohë hulumtimi përqendrohet te ndryshimet në mjedisin mediatik tradicional dhe atë online në Ballkanin Perëndimor.

- 
- <sup>1</sup> Në dhjetor 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin tre-vjeçar [Safejournalists.net](https://safejournalists.net), i cili synon fuqizimin e shoqatave kombëtare të gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirive të medive, me qëllim afatgjatë të përmirësimit të të drejtave të qytetarëve për të bërë zgjedhje të bazuar në informacione. Ky veprim përfaqëson kalimin në një tjetër nivel të projektit të mëparshëm (Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Mbrojtjen e Lirisë së Medias dhe Sigurisë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e akumuluar në periudhën 2016-2018. Ky projekt financohet në kuadër të Programit për Shoqëritë Civile dhe Media 2020-2022 Mbështetje për Rrjetet Tematike Rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile.
  - <sup>2</sup> Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.
  - <sup>3</sup> Edicioni i parë i metodologjisë së kërkimit për këtë projekt kërkimor advokimi u hartua në vitin 2016 dhe më pas u përshtat me kalimin e viteve për të pasqyruar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky hulumtim u hartua dhe koordinua nga Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë shkencorë të Institutit Kërkimor për Zhvillimin Social RESIS nga Maqedonia e Veriut. ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)).

# Dy fjalë për metodologjinë

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe treguesish të hartuar në bazë të një analizë të plotë të udhëzimeve të ndryshme të hartuara nga organizatat përkatëse ndërkombëtare. Gjatë viteve të kaluara, treguesit e mëparshëm u testuan dhe u përpunuan me qëllim trajtimin sa më koherent të kontekstit të veçantë social-politik të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe për të pasqyruar nevojat specifike dhe interesat e gazetarëve në të shtatë vendet e rajonit.

U zbatuan një sërë metodash të ndryshme kërkimore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjeve që lidhen me secilin tregues specifik:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve politike, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizës cilësore e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analizimi i informacionit të botuar në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe organizatave dhe enteve të tjera;
- Marrja dhe analizimi i deklaratave për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesioniste;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Diskutime në fokus grupe me gazetarë; dhe
- Sondazh me gazetarët (në disa vende).

Në Shqipëri, hulumtimi i advokimit u realizua nga studiues kombëtarë që mblodhën të dhënat dhe hartuan raportin narrativ, i cili më pas u rishikua nga ekspertë vendas për median dhe nga drejtuesi i hulumtimit. Për redaktimin e raportit për Shqipërinë Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt angazhoi Blerjana Binon si studiuese kombëtare, Kristina Vokon si eksperte për medias dhe Erida Skëndajn si eksperte ligjore.

Tabela 1: Indikatorët e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve

A Mbrojtja ligjore	B Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve	C Siguria e gazetarëve
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë
A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	B2 Pavarësia editoriale në mediat private	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	B3 Pavarësia editoriale e transmetuesve të shërbimit publik	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve
A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse	
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	

#### List of Abbreviations

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
ATSH	Agjencia Telegrafike Shqiptare
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
BP	Ballkani Perëndimor
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KE	Komisioni Evropian
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KNQ	Konferenca Ndërqeveritare BE-Shqipëri
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MIA	Agjencia për Media dhe Informim
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
RTSH	Radiotelevizioni Shqiptar
SPAK	Prokuroria Speciale Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
TSHP	Transmetuesi i Shërbimit Publik



Pavarësisht progresit të konsiderueshëm drejt demokratizimit të vendit tridhjetë vjet pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria ka bërë hapa prapa në demokraci në këto vitet e fundit, siç evidentohet në raporte të ndryshme të pavarura kombëtare dhe ndërkombëtare për gjendjen e demokracisë në vend. Raporti “Liria në Botë 2023” (‘Freedom in the World 2023’)<sup>4</sup>, e klasifikon Shqipërinë si Pjesërisht të Lirë për sa i përket të drejtave politike dhe lirive qytetare, ndërkohë edhe në Raportin “Kombet në Trancizion 2022” (Nations in Transit 2022)<sup>5</sup> Shqipëria nuk ka ndryshim të pikëve për demokracinë në vend. Ajo është republikë parlamentare me parlament me një dhomë dhe ka një kushtetutë që e miratoi në vitin 1998 dhe ka bërë 7 ndryshime deri në 2022.<sup>6</sup> Ka sistem zgjedhor proporcional bazuar në konkurrimin në 12 zona elektorale dhe përcaktimit të një pragu kombëtar. Shqipëria është anëtare e NATO-s që nga viti 2009 dhe e konsideron aleancën e saj Euro-Atlantike të një interesi strategjik kombëtar me rol përgjithësisht konstruktiv në Ballkanin Perëndimor duke harmonizuar plotësisht politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë me ato të Bashkimit Evropian (BE). Ajo ka një larmi pakicash etnike të njohura me ligj, siç pakicat greke, maqedonase, vlleh/arumune, rome, egjiptiane, malazeze, bullgare, boshnjake dhe serbe.<sup>7</sup>

4 Freedom House, 2022. Raporti për Shqipërinë. Aksesusar më 03.03.2022, në adresën <https://freedomhouse.org/country/albania>

5 Freedom House, 2022. Kombet në tranzicion: Shqipëria, Aksesusar më 03.03.2022, në adresën <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022>

6 Kushtetuta e Shqipërisë, miratuar në 1998 dhe ndryshuar në 2007, 2008, 2012, 2015, 2016, 2020, 2022, aksesusar në adresën <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

7 Ligji 96/2017 ‘Për pakicat kombëtare në Shqipëri’, aksesusar në <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>

Në Shqipëri rruga drejt integritit evropian ka qenë shpesh forca kryesore lëvizëse e reformave demokratizuese. Si vend kandidat i Bashkimit Evropian (BE) që nga viti 2014 Shqipëria hapi negociatat e anëtarësimit me BE-në në mars 2020, në pritje të përmbushjes së një sërë kushtesh, përfshirë këtu edhe zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021, të cilat u konsideruan si një moment historik i rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE. Në korrik 2022<sup>8</sup> u mbajt Konferenca e parë Ndërqeveritare (KNQ), që shënon edhe fillimin e një faze të re dhe vendimtare për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.<sup>9</sup> Në 2022, qeveria shqiptare ngriti struktura të ndryshme dhe nisi punën përgatitore për vlerësimin e nivelit të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së nëpërmjet procesit të shqyrtimit.<sup>10</sup>

Pavarësisht optimizmit që përshkon diskutimet mbi anëtarësimin e Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) në BE gjatë vitit 2022, progresi i prekshëm drejt një anëtarësimi të tillë mbetet i largët, siç dëshmohet edhe nga rezultatet e Takimit BE-BP mbajtur në Tiranë më 6 dhjetor 2022. Ndonëse BE theksoi angazhimet e saj financiare për rajonin, përfshirë këtu një Plan Ekonomik dhe Investimesh prej 30 miliardë eurosh që ka në fokus kryesisht projektet në infrastrukturë<sup>11</sup>, perspektivat e Shqipërisë dhe rajonit për t'u anëtarësuar në BE mbetën të pasigurta.<sup>12</sup> Niveli i ndryshëm i progresit të arritur mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm, si nevoja për reforma të mëtejshme demokratike, shqetësimet për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe interesat e ndryshme të shteteve anëtare të BE-së. Rrjedhimisht, Shqipërisë do t'i duhet të vazhdojë përpjekjet për të përmbushur standardet e BE-së, për të konsoliduar zhvillimin demokratik dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive qytetare teksa përshkon rrugën e vështirë drejt anëtarësimit në familjen evropiane.

Pushteti qendror dhe ai vendor në Shqipëri janë në parim demokratikë, por në praktikë ato dominohen nga politika klienteliste partiake dhe niveli i lartë i korrupsionit. Siç evidentohet edhe nga Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2022, Shqipëria renditet në vendin e 101 nga 180 vende, duke bërë një përmirësim të lehtë prej +1 që nga viti 2021, por jo ndonjë progres të konsiderueshëm.<sup>13</sup> Edhe pse Shqipëria është disi e përgatitur për të luftuar korrupsionin, në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe mbetet një problem shqetësues e serioz, siç theksohet edhe në raportin e Komisionit Evropian (KE) për vitin 2022: "U arritën disa rezultate, por mbeten të nevojshme vullneti më i madh politik, përpjekjet e mëtejshme të strukturuar dhe burimet dhe aftësitë e duhura."<sup>14</sup> Natyra e përhapur e korrupsionit minon besimin e publikut tek institucionet, pengon zhvillimin ekonomike dhe dëmton përparimin e Shqipërisë drejt integritit evropian.

Ashtu si vitet e kaluara, edhe në 2022, peizazhi politik u karakterizua nga një polarizim i tejskajshëm jo vetëm mes partisë në pushtet dhe opozitës, por edhe brenda vetë partisë kryesore opozitare, të cilat shpesh marrin më shumë vëmendje sesa zhvillimi i politikave publike dhe zbatimi i reformave të nevojshme. Aktualisht, Partia Socialiste e Shqipërisë është në pushtet në mandatin e saj të tretë, pas fitores në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Për sa i përket qeverisjes vendore, që nga viti 2021, Partia Socialiste kontrollon 59 nga 61 bashkitë në vend<sup>15</sup>, pas bojkotit nga opozita të zgjedhjeve vendore të 2019. Zgjedhjet e pjesshme vendore që u mbajtën në mars 2022 nuk sollën ndryshime në këtë konfigurim politik në nivel vendor. Zgjedhjet e reja të përgjithshme vendore janë caktuar të mbahen më 14 maj 2023. Gjithsesi, janë ngritur shqetësimet për integritetin e zgjedhjeve vendore që do mbahen, veçanërisht në dritën e avantazheve të mundshme të partisë në pushtet, shqetësime ndër të cilat janë përdorimi i postit, fushatat propagandistike agresive dhe dobësimi e përçarja e opozitës.

Në vitin 2022, nga raporte të ndryshme evidentohet dhe konfirmohet mungesa në përgjithësi e kulturës së hapjes dhe transparencës së institucioneve publike në Shqipëri. Kjo shfaqet në procese konsultimi sa për sy e faqe, në praktika të papërgjegjshme, në angazhim se-

- 8 Këshilli i Bashkimit Evropian, 2022, Konferenca e Parë Ndërqeveritare me Shqipërinë, Aksesuar më 03.03.2022, në adresën <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2022/07/19/intergovernmental-conference-at-ministerial-level-on-the-accession-of-albania/>
- 9 Komisioni Evropian, 2022, Konferenca e Parë Ndërqeveritare me Shqipërinë, Aksesuar më 03.03.2022, në adresën [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/first-intergovernmental-conferences-albania-and-north-macedonia-kick-start-accession-negotiation-2022-07-19\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/first-intergovernmental-conferences-albania-and-north-macedonia-kick-start-accession-negotiation-2022-07-19_en)
- 10 Bino, D., Dodbibba, A., Fabi, B., 2022. The engagement of CSOs in the EU Integration process in Albania, Center Science and Innovation for Development, në adresën <https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2022/12/Raportit-FES-web.pdf>
- 11 Këshilli i Bashkimit Evropian, 2022, Takimi BE-BP në Tiranë, Aksesuar më 03.03.2022 <https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-summit/2022/12/06/>
- 12 Lynch, Suzanne. 2022. "EU membership for Western Balkans remains far off, despite upbeat talks", Politico, në adresën <https://www.politico.eu/article/eu-membership-western-balkan-albania-edi-rama-michel-von-der-leyen-european-union/>

- 13 Transparency International, 2022, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Shqipëria, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/alb>
- 14 Komisioni Evropian, 2022, Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>
- 15 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Të dhënat e Bashkisë. "Bashkia Shkodër e drejtuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Bashkia Finiq nga Partia MEGA e Minoritetit Grek".

lektiv të aktorëve kryesorë dhe në tendencën për të mos dhënë informacione. Ndonëse raporti i KE-së pranon se është vënë në funksion ueb-portali elektronik për konsultimin publik dhe është përmirësuar kuadri rregullator, raporti thekson nga ana tjetër se është ulur përqindja e akteve ligjore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe përdorimit të regjistrat elektronik si dhe është kufizuar kontrolli i cilësisë së konsultimet publike.<sup>16</sup> Për më tepër, ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar kontrollin mbi punën e qeverisë nga publiku, për të forcuar mbikëqyrjen parlamentare të performancës së qeverisë dhe për të përmirësuar monitorimin rregullator dhe institucional. Ndonëse kuadri ligjor dhe rregullator i Shqipërisë në lidhje me të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, mjedisi i shoqërisë civile, që në dokumente duket gjithësisht mjaft aktiv, përballet me kufizime të konsiderueshme në praktikë, veçanërisht kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e vërtetë në proceset e konsultimit. Në raportin e KE-së theksohet se në vitin 2022 nuk është bërë përparim në drejtim të zbatimit të udhërrëfyesit për krijimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile. Po ashtu, pavarësisht vullnetit të fortë politik në dukje dhe ngritjes së disa strukturave, angazhim efikas i shoqërisë civile në negociatat e anëtarësimit në BE për Shqipërinë mbeten ende një detyrë që duhet përfunduar.<sup>17</sup> Gjatë vitit 2022, pesë organizata të shoqërisë civile<sup>18</sup> u përgatitën për të paraqitur një ankesë para Gjykatës Kushtetuese lidhur me antikushetshmërinë e disa nga dispozitat e Ligjit nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, e cila u paraqit më pas në ditët e para të janarit 2023. Megjithëse projektligji prekte drejtpërdrejt sektorin, ai u konsultua nga Ministria e Drejtësisë dhe Parlamentin në një klimë formale me sektorin dhe u miratua pa marrë parasysh shumë kërkesa të organizatave për qartësi, siguri juridike dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtës së asociimit.

Pavarësisht se po vazhdon të përballet me detyrën tejet të vështirë për trajtimin e pasojave ekonomike dhe sociale të goditjes së trefishtë të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, pandemia e 2022 e 2021 dhe lufta e shkaktuar nga agresioni ruse kundër Ukrainës në 2022, Shqipëria vazhdon të bëjë përpjekje për përparim dhe stabilitet. Siç thekson edhe Banka Botërore, Shqipëria është ekonomi në tranzicion që ka zbatuar reforma të rëndësishme strukturore drejt zhvillimit të balancuar, rrit-

jes së prodhimit, konkurrueshmërisë, krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të shërbimeve publike.<sup>19</sup>

Në vitin 2022, një nga sfidat më të mëdha me të cilat u përball Shqipëria ishte trajtimi i sulmeve kibernetike në masë ndaj sistemeve të saj të qeverisjes elektronike. Besojë se këto sulme të ishin të lidhura me strehimin në vend të një grupi disident iranien, që më pas çoi në implikime më të gjera gjeopolitike ku përfshihje Irani, Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara.<sup>20</sup> Qeveria shqiptare i kërkoi Microsoft-it të hetonte çështjen dhe në raportin që u publikua u deklarua me “besim të madh” se sulmet ishin vepër e “aktorëve të sponsorizuar nga qeveria iraniane”, duke identifikuar grupin disident si “shënjestrën kryesore”.<sup>21</sup> Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë jo vetëm që dëmtojnë funksionimin e qeverisë dhe tentuan të gërryjnë besimin tek institucionet financiare, por çuan edhe në rrjedhjen e një sasive të madhe informacioni konfidencial. Të dhënat personale që u publikuan kishin të bënin me emrat dhe adresat e mbi një mijë informatorëve të fshehtë të policisë, korrespondencën e postës elektronike të shefit të shërbimit të inteligjencës, të një ish presidenti dhe ish shefit të policisë, si dhe të dhënat bankare të më shumë se 30,000 vetëve.

Mediat në Shqipëri kanë bërë transformime të mëdha duke iu përgjigjur zhvillimeve social-kulturore, politike dhe ekonomike të vendit dhe përparimeve në teknologji, tendencave globale të medias dhe, ngjarjeve të kohëve të fundit. Gjithsesi, mjedisi për gazetarinë e pavarur dhe kritike si dhe për pluralizmin e mediave mbetet ende një sfida.<sup>22</sup> Tipari kryesor i sistemit mediati në Shqipëri është dominimi nga mediat klienteliste, sistem që karakterizohet nga ndërvarësia dhe lidhjet e fshehta mes mediave, politikës dhe biznesit. Shqipëria ka një sistem transmetimi të dyfishtë, ku bëjnë pjesë Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) i cili është transmetuesi i shërbimit publik dhe media e lulëzuar private me 3 kanale televizive kombëtare, përkatësisht Top Channel, TV Klan dhe Media Vizion. Në vend janë licencuar edhe ty transmetues kombëtarë për platformat digjitale. Janë licencuar edhe 39 kanale të tjera televizive (përfshirë dy

16 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

17 Bino, D., Dodbiba, A., Fabi, B., 2022. The engagement of CSOs in the EU Integration process in Albania, Center Science and Innovation for Development, në adresën <https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2022/12/Raport-FES-web.pdf>

18 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Mbrojtësit e të Drejtave Civile, BIRN Shqipëri, Aleanca kundër diskriminimit të LGBTI, dhe Këshilli Shqiptar i Medias.

19 Banka Botërore, Përmbledhja për Shqipërinë, 2022, Aksesuar më 3.5.2022. <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview#1>

20 Higgins, A., 2023, “A NATO Minnow Reels From Cyberattacks Linked to Iran”, Aksesuar më 23.03.2023, në adresën <https://www.nytimes.com/2023/02/25/world/europe/albania-iran-nato-cyberattacks.html>

21 Raporti i Microsoft 2022 për sulmet kibernetike kundër Shqipërisë, Aksesuar më 23.03.2023, në adresën <https://www.microsoft.com/en-us/security/blog/2022/09/08/microsoft-investigates-iranian-attacks-against-the-albanian-government/>

22 Media Freedom Rapid Response Report 2022, në adresën <https://www.mappingmediafreedom.org/wp-content/uploads/2023/02/MFRR-Monitoring-Report-2022.pdf>

kanale të reja në 2022),<sup>23</sup> tre radio kombëtare, katër radio komunitare, 49 radio lokale<sup>24</sup>, dhe me më shumë se 650 platforma të mediave online.<sup>25</sup>

Pavarësisht rritjes së shpejtë të numrit të mediave në dekadën e fundit, veçanërisht mediave online, cilësia e përmbajtjes mediatike mbetet një sfidë, ku për vitin 2022 kjo cilësi u përkeqësua edhe më shumë. Respektimi i standardeve etike dhe i ligjeve për të drejtën e autorit si dhe profesionalizmi ende nuk janë konsoliduar për një sërë arsyesh. Ndonëse Kushtetuta e Shqipërisë parashikon lirinë e shprehjes dhe qeveria zakonisht i respekton këto të drejta, në vitin 2022 pati raportime se qeveria, bizneset dhe grupet kriminale kërkonin të diktonin ndikimin e tyre të padrejtë në media.<sup>26</sup>

Shqipëria ka një mjedis mediatik të mbipopulluar për sa i përket numrit të mediave, por një treg të kufizuar reklamash dhe përqendrim të pronësisë së mediave tek disa pronarë/familje që i përdorin këto platforma si mjet për ndikim politik dhe ekonomik.<sup>27</sup> Interesat politike dhe ekonomike të pronarëve të mediave shërbejnë si forca të rëndësishme shtytëse që gazetarët të bëjnë censurë dhe autocensurë. Përveç kësaj, burimet e financimit për organet e medias vazhdojnë të kenë mungesë transparence. Ky përqendrim i pronësisë përbën shqetësim për pavarësinë dhe diversitetin e perspektivave të medias në vend.<sup>28</sup>

---

23 Autoriteti i Mediave Audiovizive. Aksesusar më 13.01.2022. <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/OSHMA-Audiovizive-5.pdf>

24 Autoriteti i Mediave Audiovizive. Aksesusar më 13.01.2022. <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/OSHMA-Audio-5.pdf>

25 Kjo është me përfaqësi se nuk ka të dhëna të besueshme.

26 Departamenti i Shtetit i SHBA, 2023, Raporti për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë 2022. Aksesusar më 23.03.2023 në adresën <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

27 Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, 2022, "Shqipëria: Shqetësimet për pluralizmin dhe transparencën e mediave nxisin përkeqësimin e lirisë së medias". Aksesusar më 23.03.2023 në adresën <https://www.ecpmf.eu/albania-media-pluralism-and-transparency-concerns-fuel-deterioration-in-media-freedom/>

28 Voko, K., & Likmeta, B., (2022) *Indeksi i Pluralizmit të Mediave në Shqipëri 2022*. Aksesusar më 23.03.2023 në adresën <https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/74680/MPM2022-Albania-EN.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

### A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë

A garantohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo e drejtë edhe aksesin në internet? A zbatohen në praktikë garancitë ligjore?

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe lirinë e informimit<sup>29</sup>. Këto të drejta janë përfshirë në kategorinë e të drejtave kushtetuese që mund të jenë subjekt i kufizimit, vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë proporcional me situatën që e diktoi, esenca e lirive dhe të drejtave nuk duhet të shkellet dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>30</sup> Ndërkohë, ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kufizon të drejtën për informacion që prod-

<sup>29</sup> Neni 22 i Kushtetutës shprehet: “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.” Neni 23 i Kushtetutës garanton në mënyrë të veçantë lirinë e informimit: “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtado i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

<sup>30</sup> Kushtetuta përcakton se këto kufizime duhet të jenë “në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë” dhe se “në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

hohet ose mbahet nga autoritetet publike ose që lidhen me to.<sup>31</sup> Legjislacioni në fuqi për lirinë e shprehjes nuk përfshin përmend specifikisht aksesin në internet. Megjithatë, në Shqipëri, aksesimi në internet është i garantuar përmes standardeve të elaboruara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.<sup>32</sup> Pavarësisht garancive kushtetuese për lirinë e medias, lirinë e shprehjes dhe informacionit në Shqipëri, gjatë gjithë vitit 2022 u vunë re vazhdimisht shenja të përkeqësimit në këto fusha. Pas një misioni dyditor faktmbledhës në Tiranë, më 17-18 nëntor 2022, partnerët e Platformës së Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve vlerësuan se në përgjithësi liria e mediave në Shqipëri vazhdon të përkeqësohet. Ndonëse kuadri ligjor mbetet përgjithësisht i përshtatshëm, nuk është bërë asnjë përpjekje në vitet e fundit në drejtim të përmirësimit të mjedisit për gazetarinë e pavarur dhe kritike apo për forcimin e pluralizmit të mediave.<sup>33</sup> Po ashtu, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri i vitit 2022 identifikoi mungesën e mediave të pavarura si shqetësimin parësor në lidhje me të drejtat e njeriut në vend.<sup>34</sup> Për më tepër, në draft raportin e tij Parlamenti Evropian shpreh shqetësimin për mungesën e progresit në përbushjen e transparencës institucionale, lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias dhe thekson rolin e udhëheqësve politikë për krijimin e një mjedisi të favorshëm për respektimin e këtyre lirive; dënon përpjekjet për të diskredituar gazetarët dhe fshehjen arbitrare të informacionit publik, si dhe dështimin për të garantuar sigurinë e gazetarëve.<sup>35</sup>

**A është hartuar legjislacioni për mediat nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me shoqatat përkatëse profesionale?**

Një zhvillim pozitiv në vitin 2022 ishte tërheqja e plotë e paketës antishpijës dhe qeveria nuk bëri më përpjekje për prezantimin e ndryshimeve të reja ligjore gjatë këtij vitit. Gjithsesi, në Raportin Vjetor të Komisionit Evropian për vitin 2022 theksohej se nuk është bërë progres me

lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave. Po ashtu, në raport theksohet se çdo ndryshim i mundshëm në ligjin e medias duhet të jetë në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias dhe t'i nënshtrohet konsultimeve të duhura me organizatat e mediave<sup>36</sup>. Në shtator të vitit 2022, qeveria paraqiti për konsultim publik projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me qëllim transpozimin e Direktivës (BE) 2018/1808.<sup>37</sup> Ky projektligj, ka për qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me nevoja të veçanta, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, përforcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë (on demand service). Në të gjejnë vend, trajtimi i koncepteve të reja si bashkëregullimi, vetërregullimi dhe edukimi mediatik.<sup>38</sup> Ndryshimet priten të miratohen në 2023.<sup>39</sup> Gjithashtu, në vitin 2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive ndërmori një rishikim të Kodit të Transmetimeve Audiovizive, pesë vjet pas zbatimit të tij, me synim përmirësimin e dispozitave që lidhen me barazinë gjinore, trajtimin e gjuhës së urretjes dhe disinformimit. Ky proces rishikimi është kryer në konsultim me shoqërinë civile, organizatat e mediave dhe me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë.<sup>40</sup>

**A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të vendosur kërkesa të rrepta licencimi ose kërkesa të tjera për krijimin e mediave të shkruara dhe online? A shkojnë këto kërkesa përtej një regjistrimi të thjeshtë biznesi dhe te organet tatimore?**

Në vitin 2022 nuk pati përpjekje ligjore nga autoritetet shtetërore për të imponuar licencime ose kërkesa rigorozë për krijimin e mediave të shkruara dhe ato online. Ndonëse kryeministri ende deklaroi se synon t'i rikthehet përpjekjeve për rregullimin e mediave online, deri tani nuk janë propozuar amendamente të tilla. Aktualisht, nuk ka asnjë ligj që detyron licencimin e mediave të shkruara dhe atyre online përveç regjistrimit të biznesit dhe regjistrimit tek organet tatimore. Portalet online regjistrojnë domenin e tyre tek Autoriteti

31 Neni i ligjit, i aksesuar [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligji\\_119\\_2014\\_18.09.2014.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligji_119_2014_18.09.2014.pdf)

32 *Cengiz and Others v. Turkey*, ECtHR judgment of 1 December 2015, §§ 49 and 52 and other relevant case-law; Source: Factsheet 'Access to Internet and freedom to receive and impart information and ideas', September 2022, available at [https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Access\\_Internet\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Access_Internet_ENG.pdf)

33 Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, 2022, "Shqipëria: Shqetësimet për pluralizmin dhe transparencën e mediave nxisin përkeqësimin e lirisë së medias", aksesuar më 23.03.2023 në adresën <https://www.ecpmf.eu/albania-media-pluralism-and-transparency-concerns-fuel-deterioration-in-media-freedom/>

34 Departamenti i Shtetit i ShBA-ve 2023, Raporti për Shqipërinë 2022, aksesuar më 23.03.2023 në adresën <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

35 Raporti i plotë gjendet këtu [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-739812\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/AFET-PR-739812_EN.pdf)

36 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

37 Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013", aksesuar më datën 23.03.2023, në adresën: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/514>

38 Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013", aksesuar më datën 23.03.2023, në adresën: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/514>

39 Ndryshimet dhe implikimet do të trajtohen në raportin e 2023 pasi të miratohen.

40 Kjo është ende në vazhdim dhe pritet të finalizohet në vitin 2023. Përgjigja u mor pas një kërkesë për informacion që iu dërgua AMA-s, janar 2023.

i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili u kërkon atyre të japin informacione bazë për pronësinë dhe informacione kontakti. Nëse portalet e reja kryejnë vepërimitari ekonomike, të tilla si reklama dhe abonime, ato duhet të regjistrohen tek organet tatimore. Në Shqipëri nuk ka një regjistrë publik të pronarëve të medias.<sup>41</sup> Të dhënat për pronësinë e mediave mund të merren nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe botuesit jofitimprurës duhet të regjistrohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Edhe për vitin 2022 nuk ka asnjë përkufizim ligjor për mediat online.

**A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të kufizuar të drejtën e aksesit në Internet ose për të kërkuar bllokimin ose filtrimin e materialeve në internet?**

Në vitin 2022, qeveria nuk e kufizoi apo nuk e ndërpreu aksesin në internet, përfshirë këtu autorizimin për mbyllje të pjesshme apo të plotë të aksesit në internet, apo nuk censuroi përmbajtjen online.<sup>42</sup> Ka pasur raporte të besueshme se qeveria ka monitoruar komunikimet private online pa autorizimin e duhur ligjor.<sup>43</sup> Në Shqipëri, arsytet kryesore për kufizimet e mundshme të lirisë së shprehjes online të rregulluara me ligj janë shpifja, gjuha e urrejtjes, materialet që mbrohen nga e drejta e autorit si dhe mbrojtja e të dhënave. Në këtë prizëm, në vitin 2022, pas sulmeve kibernetike që iu bënë në masë sistemit të e-qeverisjes në Shqipëri, pati raste ku autoritetet publike i ndaluan organet e mediave të botonin informacionet e rrjedhura duke ngritur si shqetësim përhapjen e panikut në publik.<sup>44</sup>

*Më 19 shtator 2022, Prokuroria e Tiranës vendosi kufizim të plotë për mediat dhe publikun për publikimin e çdo të dhëne apo informacioni nga dosjet e hakuara gjatë sulmeve të fundit kibernetike që prekën serverët shtetërorë në Shqipëri që prej muajit korrik. Hetimi i Microsoft nxori në pah se këto sulme vinin nga grupe të ndryshme hakerash iraniane, të cilët shkaktuan dëme*

*të konsiderueshme në bazat e të dhënave të qeverisë dhe sistemet kompjuterike të institucioneve publike. Dosjet e hakuara, të publikuara nga një grup i quajtur 'Drejtesia e Atdeut' që dyshohet se kanë lidhje me hakerët iranianë, kishin informacione të klasifikuara të policisë dhe korrespondencë konfidenciale mes politikanëve, autoriteteve, institucioneve shqiptare dhe ambasadorëve të huaj. Kjo bëri që qeveria shqiptare të akuzonte Iranin si përgjegjës, gjë që çoi në ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve. Pas rrjedhjeve, mediat shqiptare publikuan artikuj në lidhje me përmbajtjen, duke theksuar komplotet e dyshuara për atentat dhe çështjet që lidhen me Policinë e Shtetit. Prokuroria e Tiranës e arsyetoi kufizimin e plotë me çështjet e sigurisë kombëtare dhe privatësisë, duke paralajmëruar se ata që publikonin të dhënat në çdo formë do të përballëshin me procedimin e menjëhershëm penal sipas nenit 293/b të Kodit Penal, duke e trajtuar si "ndërrhyrje në të dhënat kompjuterike" dhe 192/b "ndërrhyrje në sistemet kompjuterike". Në deklaratë thuhet se çdo faqe interneti që kapet duke postuar të dhënat e hakuara do të bllokohet. Prokuroria caktoi një njësi hetimi të krimit kibernetik pranë Policisë së Shtetit për të monitoruar shkeljet dhe kërkoj informacion nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Më 20 shtator, AMA doli me një deklaratë ku theksonte se dosjet e hakuara përmbanin të dhëna sensitive dhe u kërkoj redaksive të tregonin maturi dhe përgjegjësi profesionale në trajtimin e publikimit të të dhënave.*

Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt së bashku me organizata të tjera të mediave reagan lidhur me kufizim të plotë të publikimit që imponoi prokuroria dhe i bëri thirrje asaj dhe qeverisë shqiptare të shmangin marrjen e çdo hapi të mëtejshëm që cenonte ushtrimin e gazetarisë së përgjegjshme apo që rrezikonte lirinë e gazetarëve që publikonin materiale me interes publik.<sup>45</sup> Gjithashtu, vlen të theksohet se ndalimi i vendosur nga autoritetet shqiptare nuk është i legjitimuar nga dispozitat e përmendura të Kodit Penal Shqiptar, i cili dënon grupet e hackers-ave dhe jo mediat e lira që përcjellin informacionin e rrjedhur tek publiku.

41 Duke marrë parasysh se mediat mund të jenë në pronësi të kompanive që mbulojnë sektorë të ndryshëm, është e vështirë të identifikohen pronarët e mediave në Regjistrin Kombëtar të Biznesit pa një regjistrë publik të pronarëve të mediave ose një Impressum në faqet e mediave.

42 Me krijimin e bazës së të dhënave online nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) në vitin 2020, ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP) tani do të informohen automatikisht për të gjitha vendimet përkatëse për heqjen e përmbajtjeve të paligjshme që jepen nga autoritetet kompetente. Zbatimi i këtyre vendimeve do të monitorohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

43 Departamenti i Shtetit i ShBA-ve 2023, Raporti për Shqipërinë 2022. Aksesuar më 23.03.2023 në adresën <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

44 Këshilli i Evropës, Siguria e Gazetarëve, 2022. Aksesuar më 23.03.2023 në adresën [https://fom.coe.int/en/Njoftim\\_i\\_rëndësishëm\\_e\\_detail/107638034:globalSearch=false](https://fom.coe.int/en/Njoftim_i_rëndësishëm_e_detail/107638034:globalSearch=false)

45 "Shqipëri: Media nuk duhet të ndiqet penalisht për raportimet me interes publik", në adresën <https://safejournalists.net/albania-media-must-not-face-criminal-prosecution-for-public-interest-reporting/?fbclid=IwAR0Yj78zvuOrG3vRfBrsq8leAKuOAKySvaQQB1Cic/VZ355e2uN2UEIwsl>

A po i kryen autoriteti rregullator funksionet e tij në një mënyrë të pavarur dhe jo-diskriminuese? A administrohen rregulloret për licencimet dhe rregulloret e tjera të transmetimit në një mënyrë të drejtë dhe të paanshme?

Shqetësimet në lidhje me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) - autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive – për sa i përket pavarësisë dhe praktikave të saj të punës u ritën pas zgjedhjes së Armela Krasniqit, një personi me lidhje politike me partitë pushtet si kryetar i AMA-s në korrik 2021.<sup>46</sup> Lidhjet e ngushta të Krasniqit me Kryeministrin Rama dhe Partinë Socialiste në pushtet si dhe roli i saj i mëparshëm si zëdhënëse e Partisë Socialiste dhe drejtoreshë e Agjencisë Telegrafike Shqiptare që është në varësi të qeverisë, u bënë shkak për shqetësime në lidhje me pavarësinë e saj. Në shkurt 2022, Kuvendi i ri zgjodhi anëtarët e drejtues të AMA-s (duke plotësuar 6 vendet vakante) sipas formulës së përfaqësimit në ligjin për median që i jep të drejtën opozitës dhe partisë në pushtet të refuzojnë kandidatët e propozuar nga organizatat e shoqërisë civile në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Pavarësia e disa anëtarëve të AMA-s është vënë në pikëpyetje për shkak të lidhjeve të tyre politike.<sup>47</sup> Gjithashtu, vlen të theksohet se formula ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të AMA-s, sipas neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit për mediat audiovizive, nuk garanton në fakt pavarësinë e saj, pasi 4 anëtarë të saj zgjidhen me mbështetjen e shumicës parlamentare dhe 3 anëtarë si propozim i opozitës parlamentare. Procesi i licencimit në Shqipëri nuk duket se është ndonjë problem i madh, sepse shumica e frekuencave tashmë janë shpërndarë dhe kalimi në transmetimin dixhital ka përfunduar.<sup>48</sup>

A abuzohet me dispozitat ligjore për reklamat shtetërore në media për të ndikuar politikisht te politika e tyre editoriale? A është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese ndarja e fondeve shtetërore? A i publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhënat për shumat e akorduara për media të ndryshme?

Në Shqipëri, reklamimi në median e shkruar dhe atë online nuk rregullohet në mënyrë të posaçme, por vetëm në kuadër të detyrimeve tatimore që duhet shlyer sipas ligjeve për tatimet dhe biznesin. Edhe pse Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) monitoron volumin e reklamave në mediat audiovizive, raportet e saj nuk janë në gjendje të përcaktojnë pozicionin e secilës media për sa i përket tregut të reklamave. Rezoluta e Parlamentit Shqiptar mbi performancën e AMA-s për vitin 2022, rekomandon që AMA të propozojë ndryshimet e nevojshme në legjisllacionin mbi reklamat për të bërë që të plotësojnë standardet ndërkombëtare.<sup>49</sup> Burimi kryesor i financimit nga shteti për mediat private është financimi që jepet për transmetimin e reklamave ose njoftimeve shtetërore, ose financimi për ngjarje publike apo fushata publicitare. Megjithatë, ka shumë pak transparencë në lidhje me kriteret e ndarjes së fondeve shtetërore, për të dhënat specifike për shumat e alokuara dhe për konflikte të mundshme interesi. Raporti vjetor 2022 i KE-së për Shqipërinë nënvizon se: “Shqipëria ka ende nevojë të miratojë ligje për forcimin e transparencës së reklamave me fonde publike.”<sup>50</sup> Institucionet shtetërore mund të përdorin ndërmarrjet e shërbimeve komunale ose agjenci reklamash për të shpërndarë fondet pa publikuar të dhëna të qarta në lidhje me kriteret dhe shumat e dhëna për mediat. Reklamimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore ka një ndikim shumë më të madh. Pronarët e bizneseve të mediave i përdorën këto të fundit si mjete për të fituar favore nga qeveria apo aktorë të tjerë të fuqishëm.<sup>51</sup> Varësia e mediave nga këto burime financimi ka çuar në ndikim të padrejtë në politikën e tyre editoriale dhe në marrëdhënie simbiotike mes politikës dhe biznesit. Një praktikë mjaft shqetësuese e mediave në vitin 2022 është edhe ajo e shantazhimit të bizneseve, partive

46 Për më shumë vizitoni <https://safejournalists.net/safejournalists-network-sent-a-letter-of-concern-to-the-speaker-of-the-albanian-parliament-and-international-organisation/>

47 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

48 Barometri aktiv i informacionit, 2022, Shqipëria, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://www.irex.org/files/vibrant-information-barometer-2022-albania>

49 Rezoluta e Parlamentit Shqiptar mbi performancën e AMA, 2022, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-vjetor-%E2%80%93-AMA-%E2%80%93-2021-Rezolut%C3%AB-p%C3%AB-r-vier%C3%AB-simin-e-veprimtaris%C3%AB-s%C3%AB-AMA-s-p%C3%AB-vitin-2021.pdf>

50 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

51 Departamenti i Shtetit i ShBA-ve 2023, Raporti për Shqipërinë 2022, aksesuar më 23.03.2023 në adresën <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>



apo individëve duke i kërcënuar me mbulim negativ mediatik.

*Konflikti mes kryeministrit Edi Rama dhe Top Channel, televizionit të dytë më të madh në Shqipëri, nxjerr në pah marrëdhënien e pasigurt mes politikës dhe mediave në vend. Rama e akuzoi Top Channel se shantazhon qeverinë me mbulim negativ, ndërsa Top Channel argumenton se kryeministri po e sulmon këtë media për shkak të linjës kritike editoriale të saj ndaj qeverisë. Ky konflikt është bërë përherë e më i ashpër, teksa Rama ndërmoi fushata në rrjetet sociale duke e akuzuar median për lidhje me qeverinë ruse dhe duke përdorur taktika shantazhuese. Nga ana tjetër, Top Channel kritikoi sulmet e Ramës duke pretenduar se këto sulme erdhën pasi ky stacion televiziv transmetoi lajme që përbënin shqetësim për publikun. Ky konflikt nuk është i vetëm, pasi edhe më herët në vitin 2022, pronari i Top Channel dhe drejtues të lartë shkëmbyen akuza për shantazh me autorin e një emisioni të përjavshëm investigativ. Po ashtu, në shtator, Rama dhe Top Channel patën një konflikt publik në lidhje me sistemin e hakuar TIMS, konflikt që u përshkallëzua edhe më tej në javët e fundit. Konflikti ngre shqetësime për pavarësinë e medias dhe ndikimin e interesave politike dhe ekonomike në politikën editoriale në Shqipëri.<sup>52</sup>*

*Në korrik 2022, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në Shqipëri akuzoi pronarin e një medie, Irfan Hysenbelliun, për shantazh duke krijuar kështu një mosmarrëveshje publike mes tyre.<sup>53</sup> Kryeministri Edi Rama ndërhyri në këtë situatë, duke shprehur shqetësime se pronarët e mediave përdorin platformat e tyre për shantazh dhe duke mbështetur të drejtën e Drejtorit të Tatimeve për të shprehur shqetësimet e tij si pjesë e fjalës së lirë.<sup>54</sup> Ky rast është pjesë e një çështjeje më të madhe në Shqipëri, ku pretendimet se pronarët e mediave shantazhojnë biznese dhe individë janë më se të zakonshme, por shpesh pa prova të qarta dhe pa hetime për to.*

*Situata u përshkallëzua në shtator kur qeveria prishi dy pishina të një resort hoteli në pronësi të Hysenbelliut, me pretendimin se ato ishin ndërtime të paligjshme në tokë shtetërore. Focus Media Group e akuzoi qeverinë se po kërkonte hakmarrje për linjën e saj kritike editoriale dhe opozitare duke shkatërruar prona pa vendim*

*gjykatë dhe duke vendosur gjoba.<sup>55</sup> Qeveria i mohoi akuzat. Më pas, mediat e Hysenbelliut publikuan foto dhe biseda personale që sugjeronin se Hysenbelliu dhe kryeministri Rama kishin në të kaluarën një marrëdhënie miqësore.*

*Ky zbulim i shton një shtresë të re kompleksiteti konfliktit të vazhdueshëm mes bizneseve të Hysenbelliut dhe qeverisë shqiptare. Ai ngre pyetje për faktin se sa ndikojnë marrëdhëniet dhe lidhjet personale në veprimet e zyrtarëve të qeverisë dhe mediave. Për më tepër, ky konstatim nxit më tej perceptimin se mediat në Shqipëri janë shpesh të njëanshme dhe të kontrolluara nga interesa të fuqishme biznesi. Implikimet e këtij zbulimi mund të shtrihen përtej këtij konflikti dhe të thellojnë mosbesimin e publikut të qeveria dhe mediat në Shqipëri.*

**A ka ndonjë lloj subvencionimi ose fonde për mediat për prodhimin e përmbajtjes mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?**

Në Shqipëri, përveç transmetuesit publik që ka fonde të veçanta për programet për pakicat kombëtare, nuk ka asnjë subvencion apo fonde për mediat për të prodhuar përmbajtje mediatike me interes publik. Profesionistët e mediave, gazetarët dhe shoqatat e mediave kanë këmbëngulur por pa sukses të jepen subvencione të tilla për të mbështetur diversifikimin dhe larminë në programet e mediave

**Cilat janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave kombëtare?**

Në Shqipëri, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) merr financime të posaçme për programet e pakicave, përfshirë këtu për programet në gjuhët e pakicave kombëtare. Radiotelevizioni publik duhet të transmetojnë edhe në njërin prej kanaleve të tij lajme dhe programe kulturore në gjuhën e pakicave (greke, maqedonase dhe rome [Ligji 97/2023, Neni 91]). Mediat private në gjuhët e pakicave kombëtare, si greqisht apo maqedonisht, mbështeten tek të ardhurat nga reklamat dhe sponsorizimet si burime kryesore të financimit të tyre. Gjithsesi, nuk ka mekanizma të veçantë për financimin e mediave në gjuhët e pakicave kombëtare përtej këtyre burimeve të të ardhurave. Gazetarët dhe shoqatat e mediave kanë arsyetuar se duhet të jepen subvencione për të mbështetur rritjen e

52 Për më shumë hollësi shih njoftimin e Safe Journalists Network në adresën <https://safejournalists.net/albania-prime-minister-accuses-media-of-blackmail-questions-of-media-credibility-and-professionalism-rise/>

53 Për më shumë shih: <https://exit.al/en/customs-director-accuses-media-portals-of-blackmail/>

54 Reagimi i Ramës në Twitter: <https://twitter.com/ediramaal/status/1551192526870167552> dhe <https://twitter.com/ediramaal/status/1550500814657146885>

55 Për më shumë shih: <https://balkaninsight.com/2022/09/02/albania-media-mogul-claims-government-attacked-his-businesses-over-editorial-line/>

diversitetit të programeve të mediave, por deri tani asnjë subvencion nuk është dhënë.

**A është e garantuar dhe e mbrojtur në mënyrë efikase autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik? A parashikon kuadri financiar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e tij? A përfaqëson shoqërinë në përgjithësi organi mbikëqyrës i këtij transmetuesi?**

Autonomia dhe pavarësia e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), transmetuesit publik në Shqipëri, garantohen me ligj, por në praktikë ato kanë hasur me shumë sfida. Pavarësisht zëvendësimit të të gjithë anëtarëve të Këshillit, të cilëve u kishte mbaruar mandati në maj 2021, përfshirë edhe kryetarin, u ngritën shqetësime për pavarësinë e organeve drejtuese të RTSh, sepse anëtarët u zgjodhën me mbështetjen e Partisë Socialiste, partisë në pushtet, dhe nuk kishte opozitë të vërtetë në Kuvend. Për sa i përket financimit, pavarësia e RTSh-së është e siguar, sepse financohet nga publiku, kryesisht nëpërmjet një tarife të veçantë që paguhet nga çdo familje përmes faturës së energjisë elektrike.<sup>56</sup> P.sh., në vitin 2021, ish Drejtori i Përgjithshëm i RTSh-së dhe tre anëtarë komisioni u arrestuan për shkelje të rregullave të prokurimit. Në qershor të vitit 2022, ish Drejtori i Përgjithshëm u dënua me dy vjet heqje lirie dhe ndalim mbajtje funksionesh publike për pesë vjet.<sup>57</sup> RTSH i ka publikuar të gjitha vendimet e Këshillit Drejtues në internet për vitin 2022.<sup>58</sup>

## **A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes te gazetarët**

**A janë dispozitat ligjore për shpifjen të rrepta dhe mbrojtëse për zyrtarëve të shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?**

Në Shqipëri shpifja është një kundërvajtje penale që është në kundërshtim me praktikën më të mira ndërkombëtare. Në Kodin Penal në fuqi shpifja përkufizohet si “Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit.” Sipas këtij Kodi shpifja

dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Dënimi rëndohet kur ky veprim është kryer publikisht, në dëm të disa personave ose më shumë se njëherë, respektivisht me gjobë prej katërqind deri në njëzet e katër mijë euro.<sup>59</sup> Gjithsesi, në vitin 2012, Kodi Penal u rishikua dhe u hoq dënimi me burg deri në dy vjet për shpifjen. Edhe Kodi Civil ka dispozita për shpifjen. Pavarësisht heqjes së dënimeve me burg, kriminalizimi i shpifjes është ende një shqetësim pasi mund të ketë një efekt tkurrës mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Për më tepër, gjambat e larta që vihen për shpifjet mund të kenë një ndikim negativ në qëndrueshmërinë financiare të mediave, veçanërisht atyre më të vogla.

**Sa procese gjyqësore janë hapur kundër gazetarëve nga zyrtarë të shtetit dhe politikanë gjatë vitit të kaluar?**

Në vitin 2022, ka pasur në total 30 çështje gjyqësore të hapura kundër gazetarëve apo punonjësve të mediave në Shqipëri, sipas Nenit 119 (Fyerja) dhe Nenit 120 (Shpifja) të Kodit Penal. Nga këto, 11 çështje janë ende të pazgjydhura dhe janë të mbartura nga vitet e mëparshme, ndërkohë që 19 çështje janë raste të reja. Po ashtu, ka pasur edhe 12 padi civile të bëra në vitin 2022, nga të cilat 11 janë për Nenin 617 Publikimet mashtruese ose të pasakta) dhe një padi sipas Nenit 625 (Përgjegjësia për dëmin jopasuror).

**Sa të motivuara politikisht janë vendimet e gjykatave ndaj gazetarëve? Çfarë lloj dënimesh janë dhënë?**

Sipas informacionit në dispozicion, është e paqartë se sa të motivuara politikisht janë vendimet e gjykatave kundër gazetarëve në Shqipëri. Ka pasur raportime për vonesa në shqyrtimin e çështjeve dhe mungesë transparence të marrjes së vendimeve. Megjithatë, është pozitive të theksohet se asnjë dënim me burg nuk është dhënë për gazetarët në vitin 2022, edhe pse për të vlerësuar plotësisht situatën do të nevojiteshin të dhëna më specifike për dënimet e dhëna në çështjet e ngritura kundër gazetarëve në vitin 2022.

**A e njohin gjykatat mekanizmin vetë-rregullues të krijuar (nëse ka)? A e pranojnë ato si të vlefshëm një përgjigje, korrigjim ose falje të botuar ose shpërndarë?**

Nuk ka një bazë të plotë të dhënash për vendimet e gjykatave ndaj mediave duke e bërë kështu të vështirë

56 Raportet financiare për vitin 2022 nuk janë bërë publike ende. Shih <https://rtsh.al/reth-rtsh/raporti-vjetor-ekonomiko-financiar>

57 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

58 Vendimet e Këshillit Drejtues të RTSh-së gjenden në adresën <https://rtsh.al/reth-rtsh/vendimet-e-keshillit-drejtues>

59 Neni 120 i Kodit Penal

të bëjmë një vlerësim të plotë të efektshmërisë së mekanizmave vetëregullues në procedurat ligjore. Sipas Kodit Civil, kur provohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, sepse ka botuar të dhëna të pasakta, të paplota ose të çorientuara, gjykata, me kërkesë të personit të dëmtuar, obligon personin tjetër të botojë një kundërtënie, në atë mënyrë që ajo mund të konsiderojë të përshtatshme.<sup>60</sup> Ndërsa Neni 647/a i Kodit Civil lë një diskrecion të gjerë për gjykatën për të aplikuar çdo masë tjetër të marra nga autori i deklaratave për të rregulluar nderin, personalitetin ose reputacionin e personit të dëmtuar (për shembull, duke përfshirë edhe ndjesën). Kjo praktikë njihet edhe me ligj.

### **Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin e shpifjes? A dekurajohen ata për të hetuar e për të bërë shkrime kritike?**

Gazetarët në Shqipëri, veçanërisht ata që janë të pavarur dhe kritikë kanë shprehur shqetësime për ligjin e shpifjes në Shqipëri dhe për retorikën e qeverisë për rregullimin e mediave. Shumë gazetarë besojnë se këto ligje dhe kjo retorikë që përdor qeveria kanë ndikim negativ në gazetarinë e pavarur dhe cilësore në vend. Në vitin 2022, gazetarët u përballën me sfida të mëdha, përfshirë këtu kërcënimet, ngacmimet dhe kushtet e këqija të punës. Disa gazetarë kanë raportuar se kanë praktikuar vetë-censurë për të shmangur fushatat e shpifjeve në internet, presionet në redaksi dhe ngacmimet nga aktorë të tjerë.<sup>61</sup> Këta faktorë mund t'i dekurajojnë gazetarët në investigimet dhe raportimet e tyre kritike, duke çuar potencialisht në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies në mjedisin mediatic.

### **A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media**

**A është rregulluar pluralizmi politik në media me ndonjë ligj të veçantë për mediat jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet e transmetuesit të shërbimeve publike dhe cilat janë ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore?**

Në Shqipëri, pluralizmi politik në media është i rregulluar me ligj të veçantë për Transmetuesin e Shërbimit Publik dhe për procesin zgjedhor. Edhe pse parimet e përgjithshme të paanshmërisë janë detyrim për op-

eratorët e mediave, ligji thotë se operatorët e mediave audiovizive mund të transmetojnë veprimtarinë e forcave politike, por ato duhet ta bëjnë këtë gjë pa treguar njëanshmëri politike.<sup>62</sup> Ndonëse Transmetuesi i Shërbimit Publik është i detyruar të ruajë pluralizmin politik jashtë procesit zgjedhor, mediat private nuk janë të detyruar me ligj për një gjë të tillë. Ligji për mediat audiovizive thotë se Këshilli Drejtues i TSHP duhet të monitorojë dhe garantojë paanshmërinë e informacionit dhe objektivitetin e TSHP-së.<sup>63</sup> Po ashtu, dispozita për paanshmërinë janë përfshirë edhe në Statutin dhe Politikën Editoriale të TSHP-së, ndërkohë që udhëzimet editoriale të këtij transmetuesi bëjnë thirrje për pluralizëm pikëpamjeje/opinionesh dhe raportim të balancuar. Megjithatë, është e paqartë se sa janë zbatuar dhe respektuar këto standarde, sepse nuk ka raporte nga RTSH apo AMA për efektivitetin e tyre.

### **A është i detyruar autoriteti rregullator të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik përtej procesit zgjedhor?**

Për vitin 2022, nuk ka pasur asnjë përditësim në lidhje me detyrimin e autoritetit rregullator për të monitoruar dhe mbrojtur pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore. Sipas Ligjit për Media Audiovizive, autoriteti rregullator, AMA, mbikëqyr paanshmërinë, objektivitetin dhe tërësinë e informacionit audioviziv. Megjithatë, raportet e monitorimit të AMA-s fokusohen kryesisht në monitorimin e përmbajtjes dhe frekuencës, ndërkohë që i kushtohet me pak vëmendje pluralizmit politik jashtë transmetuesit publik. Edhe pse TSHP është i detyruar me ligj të ruajë pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore, mediat private nuk janë të detyruar me ligj për një gjë të tillë. Pavarësisht përcaktimit të dispozitave për paanshmërinë në Statutin dhe Politikën Editoriale të transmetuesit publik dhe në udhëzimet editoriale të tij, nuk ka raporte nga RTSH apo AMA se sa ia kanë dalë ata të arrijnë dhe mbrojnë pluralizmin politik në media jashtë proceseve zgjedhore.

### **A kanë akses të drejtë dhe të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët e tyre përtej procesit zgjedhor?**

Jashtë proceseve zgjedhore nuk ka garanci për akses të drejtë dhe të barabartë në media edhe pse partitë dhe aktorët kryesorë politikë gëzojnë akses të

<sup>60</sup> Neni 617 i Kodit Civil

<sup>61</sup> Barometri aktiv i informacionit, 2022, Shqipëria, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://www.irex.org/files/vibrant-information-barometer-2022-albania>

<sup>62</sup> Sipas nenit 56, pika 7, ligji për mediat audiovizive parashikon si kritere për autorizimet dhe licencat për shërbime ose transmetime audio ose audiovizive që AMA parashikon, që aplikacioni përkatës të pasqyrojë përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe Struktura e programit të propozuar për transmetim, të cilat shprehin qartë pluralizmin në integritetin dhe paanshmërinë e informacionit të tyre.

<sup>63</sup> Neni 102, paragrafi 11 i ligjit për median audiovizive

konsiderueshëm në media.<sup>64</sup> Gjithsesi, ajo që është shqetësuese në Shqipëri është praktika e partive politike dhe politikanëve si dhe e zyrtarëve publikë të nivelit të lartë që veprojnë si “redaksi”, të cilët u ofrojnë mediave pamje të redaktuara dhe të përgatitura paraprakisht të aktiviteteve të tyre dhe mediat thjesht e transmetojnë ose publikojnë materialin siç e marrin atë, pa bërë një redaktim të pavarur gazetaresk.<sup>65</sup>

### Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ monitoron mediat elektronike dhe shtypin?

Në Shqipëri, detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore rregullohen nga Ligji për Mediat Audiovizive, nga Kodi Zgjedhor dhe nga Kodi i Etikës për Mediat. Ligji u kërkon të gjitha mediave të mbulojnë fushatat zgjedhore në mënyrë të drejtë dhe të balancuar, duke u dhënë mundësi të barabarta të gjitha partive dhe kandidatëve. Media audiovizive është e detyruar të bëjë dallimin ndërmjet lajmeve, komenteve dhe reklamave dhe të shmangë çdo raportim të njëanshëm, propagandë apo fushatë elektorale.

Mediat audiovizive monitorohen nga AMA për mbulimin e fushatës zgjedhore.<sup>66</sup> Që nga viti 2021, AMA është përgjegjëse për monitorimin e përmbajtjes dhe kohëzgjatjes së dedikuar aktorëve politikë gjatë fushatës së zgjedhjeve, si dhe propozon KQZ-së ndëshkime të lidhura me rregullat e Kodit Zgjedhor për mediat audiovizive në raste të shkeljeve të këtyre dispozitave. Ajo monitoron përmbajtjen dhe shpeshtësinë e reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore si dhe mbikëqyr respektimin nga mediat të detyrimeve ligjore për reklamën politike. Po ashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për sigurimin e kushteve të barabarta dhe të drejta për të gjitha subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore, përfshirë këtu edhe aksesin në media. KQZ-ja mund të vendosë sanksione ndaj subjekteve politike dhe mediave që shkelin rregullat për akses të drejtë në media gjatë fushatës zgjedhore. Monitorime të pavarura bëjnë edhe ODIHR dhe OJQ-të vendase. Nuk bëhet monitorim i mediave të shkruara apo ato online.

64 ODHIR. “Limited Election Observation Mission Final Report”, 2021. Accessed 15.3.2022. <https://www.osce.org/files/documents/5/1/493687.pdf>

65 Kjo hapësirë u jep subjekteve zgjedhore nga neni 84/1 i Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, “Duhet të identifikohet qartë informacioni për veprimtaritë e fushatës zgjedhore, të cilat përgatiten dhe transmetohen në edicione informative, bazuar në materialet e vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore. në përputhje me udhëzimet e KQZ-së” si dhe 84/1, germa “d” e të njëjtit akt, “Kur për arsye media objektive nuk është në gjendje të ndjekë veprimtaritë të veçanta zgjedhore, lejohet përdorimi dhe përzgjedhja e pamjeve nga regjistrimet e plota, serviret nga subjektet zgjedhore, me kusht që lajmi të shoqërohet me shënimin “material filmik i servitur sipas subjektit”.

66 Neni 85 i Kodit Zgjedhor

### A kanë akses të drejtë e të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore?

Në vitin 2022 nuk u evidentuan ndryshime të mëdha në lidhje me aksesin e drejtë dhe të barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore në Shqipëri. Ka dispozitat ligjore për këtë akses, por aktorët politikë përfaqësohen në mënyrë të njëanshme dhe jo proporcionale, duke favorizuar disa aktorë ndaj disa të tjerëve. Diskriminimi ndaj partive më të vogla është në kundërshtim edhe me angazhimet ndërkombëtare, dhe pamjet e të regjistruara dhe të prodhuara nga partitë politike ende transmetohen gjatë edicioneve të lajmeve. Është detyrim ligjor mbulimi i balancuar gjinor, por kandidatet femra kanë marrë më pak mbulim. Transmetuesit shqiptarë thyen kodin zgjedhor duke u dhënë më shumë kohë televizive socialistëve në pushtet sesa partive të opozitës, duke neglizhuar kështu partitë më të vogla.<sup>67</sup>

### A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve

#### A u duhet gazetarëve të licencohen nga shteti për të ushtruar profesionin? A ka pasur përpjekje gjatë vitit të kaluar për të prezantuar leje të tilla nga shteti?

Gazetarët në Shqipëri nuk kanë nevojë të jenë të licencuar nga shteti për të ushtruar profesionin, gjë që është aspekt pozitiv për lirinë e mediave.

#### A u është refuzuar gazetarëve e drejta për të raportuar një ngjarje të caktuar për shkak të mosakreditimit?

Në Shqipëri, institucionet publike përgjithësisht kanë rregullore për akreditimin e medias. Megjithatë, këto praktika shpesh favorizojnë gazetarët e lidhur me organizatat mediatike, duke vënë në disavantazh profesionistët e pavarur të mediave, blogerët dhe gazetarët e pavarur. Është më se e nevojshme të përmirësohen praktikat e akreditimit që përshtaten me mjedisin në zhvillim të gazetarisë.

67 Për më shumë hollësi për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021 vizitoni <https://balkaninsight.com/2021/07/23/men-only-media-in-albanian-election-focused-on-male-leaders/> dhe <https://balkaninsight.com/2021/06/02/albanian-election-commissioner-turns-blind-eye-to-broadcast-bias/>

Disa raste të vitit 2022 ngritën shqetësime për akreditimin dhe lirinë e medias në Shqipëri. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) prezantoi një rregullore të re për marrëdhëniet me median, rregullore që ngriti shqetësime për lirinë e medias, aksesin në informacion dhe për transparencën. Rregullorja përcaktonte se gazetarëve mund t'u hiqej akreditimi i KLP-së për shkelje të objektivitetit, profesionalizmit, Kushtetutës, ligjit ose parimeve të rregullores. Procesi për vlerësimin e profesionalizmit dhe transparencës së raportimit të gazetarëve mbetet i paqartë sikurse si edhe roli i Koordinatorit për të Drejtën e Aksesit në Informacion në KLP ose të anëtarit të Këshillit të caktuar për të mbuluar marrëdhëniet me mediat. Kjo rregullore fillimisht u shpall pa konsultime me grupet e interesit dhe vetëm pas kritikave publike KLP zhvilloi konsultime me gazetarët.<sup>68</sup>

Një shqetësim i shpeshtë në lidhje me aftësinë e gazetarëve për të raportuar në mënyrë efektive në Shqipëri buron nga praktika e zyrtarëve publikë që shpërndajnë në media materiale të parapërgatitura (audio, video dhe tekst). Në vitin 2022, Kryetari i Bashkisë së Tiranës vazhdoi t'u shmangej organizimit të konferencave për shtyp, të përjashtonte gazetarët nga ngjarjet publike dhe të shpërndante materiale të parapërgatitura për konsum mediatik. Kjo praktikë është e përhapur mes zyrtarëve të lartë në Shqipëri, përfshirë edhe kryeministrin, ministrat dhe drejtuesit e partive politike. Implikimet e kësaj mënyre komunikimi janë shumë serioze, pasi ky lloj komunikimi me publikun ngre shqetësime për lirinë e medias, aksesin në informacion dhe transparencën në vend. Duke shmangur angazhimin e drejtpërdrejtë me gazetarët dhe duke ofruar ekskluzivisht përmbajtje të parapërgatitura, zyrtarët publikë kufizojnë plotësisht mundësitë për pyetje kritike dhe raportim më të thelluar për çështje me interes publik. Njëkohësisht, kjo situatë nxjerr në pah çështjet e brendshme brenda industrisë së medias, duke qenë se mediat i pranojnë dhe i transmetojnë ose publikojnë këto materiale të parapërgatitura pa vënë në dyshim përmbajtjen e tyre me sy kritike ose duke respektuar praktikat përkatëse të gazetarisë. Kjo nxjerr në pah nevojën që organizatat e mediave të respektojnë standardet profesionale dhe të angazhohen në analizimin e plotë të informacionit të ofruar nga zyrtarët publikë për të bërë të mundur një mbulim të balancuar dhe gjithëpërfshirës.

Pavarësisht se Kryeministri dhe ministrat bëjnë deklarata për shtyp çdo të mërkurë pas mbledhjeve të Këshillit të Ministrave që nga muaji shtator 2021, numri i konferen-

cave për shtyp ku gazetarët mund të bëjnë pyetje kritike mbetet i kufizuar. Fatkeqësisht, në vitin 2022, shumica e këtyre ngjarjeve morën kryesisht formën e deklaratave formale për shtyp, duke u ofruar shumë pak ose aspak mundësi gazetarëve për të bërë pyetje. Si rrjedhojë, në këto seanca morën pjesë kryesisht operatorët e kamerave, me një mungesë të theksuar të gazetarëve. Ky skenar nxjerr në pah një mundësi të humbur për promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në punën e qeverisë. Duke mos krijuar mundësi për dialog real mes gazetarëve dhe zyrtarëve publikë, potenciali për raportim gjithëpërfshirës dhe analizë kritike të vendimeve të qeverisë ulet seriozisht. Kjo qasje minon rolin vendimtar të shtypit në një shoqëri demokratike dhe pengon përpjekjet për të promovuar hapjen dhe llogaridhënien në sytë e publikut.

Në vitin 2022, pati dy raste të rënda ku kryeministri Edi Rama qortoi gazetarët dhe i dërgoi për "riedukim" për pyetjet kritike që bënë ata. Në mars, Rama i tha gazetares Ambrioz Meta se kishte nevojë për "riedukim" dhe e ndaloi atë t'i bënte pyetje për 60 ditë. Kjo gazetares e kishte pyetur Ramën për çështje me interes publik, përfshirë arrestimin e një deputeti të Partisë Socialiste dhe një rast korrupsioni që bënte fjalë për inceneratorët. Rama e përsëriti këtë qëndrim të tijin në një tjetër konferencë shtypi në prill.<sup>69</sup>

Po ashtu, gjatë një konference për shtyp me Ministren e Jashtme Olta Xhaçka, më 1 korrik 2022, gazetari Klevin Muka nga filiali i CNN A2 u akuzua nga Rama për shkelje të etikës së gazetarit duke i bërë pyetje për konflikte të mundshme interesi Ministres së Jashtme. Si rezultat, Rama vendosi një ndalim prej tre muajsh dhe e dërgoi Mukën për "riedukim" përpara se ta lejonte të merrte pjesë në konferencat e ardhshme për shtyp<sup>70</sup>. Nga ana tjetër, mbështetja e kufizuar në redaksi për gazetarët e pavarur dhe kritikë për shkak të presionit të pronarëve dhe agjendave dhe interesave personale të fshehura të tyre është më se e qartë edhe në rastin e Mukës, i cili u izolua në redaksi, duke mos e dërguar asnjëherë të ndiqte konferenca shtypi apo duke e lënë të raportonte për ngjarje politike që nga koha e incidentit me kryeministrin. Në fund gazetari u detyrua të jepte dorëheqjen dhe të gjente një punë tjetër.

Për më tepër, ka fakte të komunikimit të qeverisë me gazetarët përmes kanaleve jozyrtare, si në grupe WhatsApp, të diskriminimit ndaj mediave të pavarura kur

68 Për më shumë shih reagimin publik të Safe Journalists Network dhe Letrën e Ankesës dërguar KLP në adresën: <https://safejournalists.net/portfolios/safejournalists-new-regulation-of-the-high-prosecution-council-violates-media-freedom-in-albania/> dhe <https://balkaninsight.com/2022/10/12/new-rule-could-limit-reporting-on-albanian-prosecutors-experts/>

69 Për më shumë hollësi për këtë çështje vizitoni platformën e Safe Journalists: <https://safejournalists.net/reports/other-threats-to-journalists-ambriozia-meta-30-03-2022-tirana/>

70 Për më shumë hollësi për rastin dhe Letrën e Hapur dërguar Kryeministrin nga Safe Journalists dhe organizata të tjera ndërkombëtare për lirinë e shtypit vizitoni: <https://europeanjournalists.org/blog/2022/07/07/open-letter-albanian-prime-minister-edi-rama-bans-journalists-from-press-conferences/>

kërkojnë informacione ose komente dhe të armiqësisë ndaj gazetarëve të perceptuar si përfaqësues të mediave të opozitës. Këto praktika theksojnë më tej sfidat me të cilat përballet shtypi në Shqipëri, duke kufizuar aftësinë e tyre për të ushtruar me efektivitet profesionin e gazetarit.

**A janë gazetarët të organizuar në shoqata profesionale dhe nëse po në ç'mënyrë?  
A ka presione mbi organizatën e tyre ose mbi anëtarët e organizatës?**

Edhe pse gazetarët janë të organizuar në shoqata profesionale, mungesa e konsolidimit dhe burimet e dhe kompetencat e kufizuara përbëjnë shqetësim. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë mbeten shoqatat më të mëdha, ku e para ka të deklaruar rreth 1,200 anëtarë dhe ka ngritur degë në 10 qytete të Shqipërisë dhe Shoqata që ka rreth 220 anëtarë dhe një bord me 12 gazetarë.

Në vitin 2021, u krijua Lëvizja e Gazetarëve për të mbrojtur statusin e gazetarit, por nuk ka pasur hapa konkretë në vitin 2022. Janë ngritur shqetësime për kërkesat e kësaj lëvizjeje, të cilat mund të çojnë në licencimin e gazetarëve dhe krijimin e një regjistri kombëtar nga qeveria. Në aspektin pozitiv, janë bërë disa përpjekje për krijimin e rrjeteve të gazetarëve të rinj apo grave gazetare në media, si krijimi i "Lajmetarja" në vitin 2022, një nismë e grave të reja gazetare në formën e shoqërisë civile. Për vitin 2022 nuk është raportuar asnjë presion ndaj shoqatave. Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, e cila përfshin Federatën Evropiane të Gazetarëve, edhe pse me kapacitete dhe ndikim shumë të kufizuar në vend.

**A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe, nëse po, si? A ka presione mbi drejtuesit e sindikatave dhe anëtarët e tjerë? A janë gazetarët të lirë të bëhen anëtarë të sindikatave?**

Në Shqipëri nuk ka sindikata të posaçme të gazetarëve. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë janë shoqata profesionale dhe jo sindikata. Sindikatat e tjera në Shqipëri nuk kanë një seksion të veçantë për punonjësit e medias dhe gazetarët. Gjetjet e Barometrit për lirinë e medias në Shqipëri në vitin 2021,<sup>71</sup> pasqyrojnë

se shumica dërrmuese e punonjësve të medias të anketuar, 97% e tyre, mendojnë se organizimi në sindikata do t'i ndihmonte drejtpërdrejt gazetarët në përmirësimin e lirisë së medias si dhe të kushteve të tyre të punës. Megjithatë, vetëm 85.5% e tyre shprehën gatishmërinë për të qenë pjesë aktive e tij, duke reflektuar një qasje hezituese për shkak të klimës frikësuese nga punëdhënësit e tyre.

Nuk ka pasur raportime për presione ndaj drejtuesve apo anëtarëve të sindikatave për vitin 2022. Gazetarët janë të lirë të bëhen anëtarë të shoqatave profesionale apo sindikatave, ndonëse shkalla e ulët e sindikalizmit në Shqipëri sugjeron se shumë gazetarë mund të mos jenë të lidhur me ndonjë organizatë të tillë.

**A ka ndonjë Këshill Shtypi dhe si është i organizuar ai? A u bëhen presione përfaqësuesve të këtij Këshilli Shtypi?**

Këshilli Shqiptar i Medias vazhdon të jetë një organizatë aktive e gazetarëve të pavarur në 2022. E regjistruar në 2015 si OJQ zyrtare në formën e një shoqate, këshilli ka në përbërje të tij më shumë se 30 gazetarë shqiptarë nga media të ndryshme. Objektivi kryesor është të promovojë një media etike, profesionale dhe të pavarur në Shqipëri. Në vitin 2020, Këshilli Shqiptar i Medias krijoi Aleancën për Media Etike si një mekanizëm vetë-rregullim për forcimin e Kodit të Etikës në vend. Aleanca për Media Etike është një grup vullnetar i mediave shqiptare e angazhuar për zbatimin rigoroz të Kodit të Etikës për Gazetarët.

Për të zbatuar mekanizmin funksional të vetë-rregullimit, aleanca shqyrton ankesat nga publiku për shkeljet etike të mediave online dhe u jep rekomandime organeve të medias. Megjithatë, këto rekomandime nuk janë të detyrueshme. Aleanca prezantoi edhe "Udhëzimet etike për gazetarinë online" për të siguruar zbatimin dhe respektimin e etikës nga mediat online. Logoja e aleancës shërben si vullë e mediave që respektojnë etikën dhe mund të shfaqet në faqet e internetit të mediave pjesëmarrëse. Që nga viti 2022, nuk ka raportime për presione ndaj përfaqësuesve të Këshillit të Shtypit apo ndaj Aleancës Shqiptare për Median Etike.

71 Publikuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, aksesuar <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi-Tetor-2022-KShH.pdf>

## A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve

Si garantohet nga legjislati konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve? Në cilat rrethana mund t'i nënshtrohet kufizimeve e drejta për të mbrojtur burimet e tyre? A garantohet me Kushtetutë e drejta për mbrojtjen e burimeve?

Në vitin 2022 nuk ka pasur ndryshime ligjore në lidhje me mbrojtjen e burimeve konfidenciale të informacionit për gazetarët në Shqipëri. Kuadri aktual ligjor thekson rëndësinë e këtij parimi dhe madje përfshin gazetarët në profesionet që nuk u kërkohet të zbulojnë burimet e tyre të informacionit, duke e konsideruar burimin si sekret profesional.<sup>72</sup> Megjithatë, nëse me vendim gjykate provohet se burimi i informacionit është provë themelore, gazetarëve mund t'u kërkohet të tregojnë burimin me vendim gjykate.<sup>73</sup> Pavarësisht kësaj mbrojtjeje ligjore, gazetarët janë të detyruar të mos zbulojnë burimet e tyre të informacionit edhe nga etika, përveç kur jepet pëlqimi i qartë nga personi i interesuar.<sup>74</sup>

A ka pasur sanksione ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të tyre?

Në 2022 nuk është asnjë rast sanksionesh apo ndëshkimesh ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të tyre.

A ndjehen të lirë gazetarët të kërkojnë akses dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?

Në vitin 2022, gazetarët në Shqipëri hasën me sfida në kërkim të burimeve të informacionit dhe mbajtjes së kontakteve me këto burime, veçanërisht për ata gazetarë që mbulojnë krimin e organizuar dhe angazhohen në gazetarinë investigative. Kjo çështje bëhet edhe më

e vështirë nga problemet në përgjithësi me sigurinë e gazetarëve dhe kushtet e tyre të punës

## A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni

Cilat janë ligjet për akses tek informacioni dhe dokumentet zyrtare që kanë lidhje me gazetarët?

Ligji Nr. 119/2014, 'Për të Drejtën e Informimit' përcakton kërkesat për transparencën e autoriteteve publike si dhe dispozitat për kërkesat për të drejtën e informimit. Me ligj është krijuar edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoriteti përgjegjës për monitorimin e respektimit të ligjit dhe vendosjen e sanksioneve ndaj autoriteteve publike që refuzojnë pa arsye të japin informacionin e kërkuar.<sup>75</sup> Megjithatë, autoritetet publike mund të mos e japin informacionin e kërkuar, nëse ky informacion lidhet me sigurinë kombëtare, sekretet tregtare, të drejtën e privatësisë, të drejtën e autorit, politikën monetare dhe fiskale, hetimet penale ose administrative në proces dhe konsultimet ndërqeveritare. Mungesa e një përkufizimi të qartë për dispozitën "interesi publik" u jep institucionet publike liri të konsiderueshme për të kufizuar ose mohuar me ligj informacionin e kërkuar.

Vlen të theksohet se gazetarët në Shqipëri janë përballur me sfida në marrjen e informacionit, veçanërisht në rastet që kanë të bëjnë me zyrtarë të nivelit të lartë apo tema të ndjeshme. Ndonëse ligji përcakton kritere për marrjen e informacionit, mungesa e zbatimit dhe mundësia e fshehjes së informacionit sipas dispozitave të përgjithshme mund t'i pengojë gazetarët të kërkojnë informacion. Përveç kësaj, kur hetohen çështje të ndjeshme, mund të vihen në rrezik siguria e gazetarëve dhe mbrojtja e burimeve të tyre.

Në vitin 2022, ndryshimet e propozuara për Ligjin Nr. 119/2014, "Për konsultimin publik" shkaktuan shqetësime serioze. Në tetor 2022, Ministria e Drejtësisë publikoi një projektligj për përmirësimin dhe forcimin e legjislati aktual për të drejtën e informimit. Megjithatë, ligji i propozuar ngre disa shqetësime. Dispozita për "kërkesat abuzive" mund t'u japë të drejtën autoriteteve publike të refuzojnë kërkesat e gazetarëve pa dhënë arsye për refuzimin e kërkesave, duke penguar kështu gazetarinë investigative dhe transparencën e qeverisë. Sanksionet e propozuara për moszbatimin e ven-

72 Për më shumë burime shih: <https://www.reporter.al/manualidrejtises/BURIMET%20DHE%20GAZETARI.html>

73 Neni 159 i Kodit të Procedurës Penale përcakton në parim se gazetarët nuk janë të detyruar të zbulojnë burimin e informacionit, duke e konsideruar atë sekret profesional. Mirëpo, në procedurën penale, kur të dhënat janë të nevojshme për të vërtetuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet zbulimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin të bëjë të ditur burimin e informacionit të tij.

74 Kodi i Etikës së Gazetarit mund të gjendet i plotë në adresën <https://ksh.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikes-final-English-4.pdf>

75 Neni 17, Ligji për të drejtën e informimit, 119/2014, Aksesuar më 24.03.2023, [https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/LAW\\_119-2014.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/LAW_119-2014.pdf)

dimeve të Komisionerit nuk adresojnë rekomandimet e shoqërisë civile. Numri i ulët i vendimeve të Komisionerit dhe mungesa e titujve ekzekutivë janë po ashtu çështje serioze që nuk trajtohen në ndryshimet e propozuara. Rrjeti SafeJournalists u bëri thirrje autoriteteve që të rishqyrtojnë propozimet e shoqërisë civile për realizimin e kësaj të drejte.<sup>76</sup> Edhe organizata të tjera të mediave shprehën shqetësime në këtë drejtim.<sup>77</sup> Ndryshimet e propozuara nuk janë miratuar ende, ndërkohë që është njoftuar dhe një takim i gjërë konsultimi për t'u mbajtur në 11 prill 2023.

**A i përdorin këto rregulla gazetarët?  
A i respektojnë pa vonesa këto  
rregulla autoritetet?**

Ndonëse Ligji për të Drejtën e Informimit përcakton kriteret për kërkimin dhe marrjen e informacionit, institucionet priren të përdorin afatin maksimal të lejuar me ligj për t'u përgjigjur ose japin të dhëna që janë të vështira për t'u përdorur. Kjo mund të shkaktojë vonesa në raportimin e gazetarëve, duke i shtyrë ata të kërkojnë informacion nga burime alternative. Mungesa e efektivitetit të mekanizmave në fuqi, siç theksohet edhe nga Raporti i KE-së, bën që vendimet e marra nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (Komisioneri) të mos jenë të detyrueshme për zyrtarët e administratës publike.<sup>78</sup> Në vitin 2022, Komisioni Evropian ndërmori një mision shqyrtimi kolegjial të institucioneve të pavarura në Shqipëri, përfshirë këtu edhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, duke organizuar konsultime me organizatat e medias dhe shoqërinë civile.

Më konkretisht, në vitin 2022, zyra e Komisionerit mori gjithsej 1032 ankesa dhe shqyrtoi 49 procedura të mbartura nga viti 2021, duke e çuar numrin total në 1081 ankesa. Nga këto, 456 ankesa ishin bërë nga gazetarë, të cilëve institucionet publike u kishin mohuar aksesin në informacion, shifër që është një rritje në krahasim me 409 ankesa në të bëra prej tyre vitin 2021. Zyra e Komisionerit arriti të zgjidhte pak më shumë se gjysmën e ankesave duke u vënë në dispozicion informacionin e kërkuar ankimesve gjatë procesit të hetimit administrativ. Nga totali prej 1081 ankesash, 643 janë zgjidhur në këtë mënyrë. Po ashtu, Zyra e Komisionerit mori

51 vendime për 61 ankesa.<sup>79</sup> Këto shifra sugjerojnë se aksesin në informacion është ende problem në Shqipëri, veçanërisht për gazetarët. Komisioneri për mbrojtjen e të drejtës së informimit ka marrë një rol ndërmjetësues për ato institucione që nuk zbatojnë siç duhet detyrimin e tyre, sesa një mekanizëm të fortë të pavarur që ka të gjitha mjetet për të aplikuar sanksione në këto raste.

**A janë përgjithësisht transparente autoritetet  
shtetërore? A krijojnë ato marrëdhënie të  
hapura, jodiskriminuese dhe të paanshme me  
mediat apo tentojnë të punojnë në fshehtësi?  
A i trajtojnë institucionet shtetërore me  
preferencë mediat politikisht miqësore me ta?**

Zbatimi i pamjaftueshëm i kuadrit ligjor për lirinë e informimit, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik, kulturës së fshehtësisë dhe mospublikimit të informacionit publik, ndikon në cilësinë dhe pavarësinë e raportimit. Organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mediave dhe organizatat ndërkombëtare për lirinë e shtypit kanë shprehur shqetësime në lidhje me marrëdhëniet publike të qeverisë dhe centralizimin e informacionit publik përmes Agjencisë së sapokrijuar për Mediat dhe Informim (AMI) dhe kufizimet e aksesit në informacion.

Në shtator 2021, qeveria shqiptare njoftoi ngritjen e një Agjencie të re për Mediat dhe Informim (AMI)<sup>80</sup> që do të centralizonte në një agjenci të vetme marrëdhëniet me publikun dhe informimin e publikut në emër të institucioneve të qeverisë gjë që bëri që organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mediave dhe organizatat ndërkombëtare për lirinë e shtypit të shprehnin shqetësime për ndikimin e AMI-t në kufizimin e informacionit për publikun.<sup>81</sup>

Drejtori i AMI-t pretendonte se ishte hedhur një hap cilësor në drejtim të transparencës së qeverisë shqiptare pas krijimit të kësaj agjencie, duke përmendur arritje të tilla si riorganizimi i faqeve të ministrive dhe komunikimi i drejtpërdrejtë i vendimeve të reja në media.<sup>82</sup> Megjithatë, janë ngritur shqetësimet për centralizimin e informacionit publik dhe pengesat për aksesin në informacion, ku janë ngritur dyshime për modelin e agjencisë dhe mungesën e informacionit specifik

76 Për më shumë informacione shih <https://safejournalists.net/portfolios/safejournalists-concerns-about-the-proposed-changes-to-access-the-information/>

77 Për më shumë hollësi për shqetësimet e organizatave të mediave shih adresën <https://balkaninsight.com/2022/10/24/albania-gov-attempt-to-block-abusive-foia-s-criticized/>

78 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

79 Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, 2023, Raporti Vjetor KDMDHP 2022, aksesuar më 30.03.2023 në adresën <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Raporti-Vjetor-2022.pdf>

80 Për më shumë shih <https://mia.gov.al/>

81 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

82 Për më shumë shih <https://www.reporter.al/2022/04/13/dukem-naiv-por-jam-idealist-endri-fuga-mbron-agjencine-e-medias-dhe-informimit/>



për stafin.<sup>83</sup> Kjo agjenci kontrollon edhe emërimin dhe shkarkimin e zëdhënësve të shtypit të këtyre institucioneve dhe monitoron aktivitetin publik të ministrave, duke ngritur shqetësime të mëtejshme për kontrollin e qeverisë mbi informacionin.

### **A janë transparente gjykatat? A sigurohet akses i medias tek procedurat ligjore në mënyrë jo-diskriminuese dhe pa kufizime të panevojshme?**

Në vitin 2022, nuk ka pasur ndryshime të konsiderueshme në lidhje me aksesin e mediave në seancat gjyqësore. Parimisht në Shqipëri mediat gëzojnë akses të paanshëm dhe të pakufizuar në proceset gjyqësore, në përputhje me ligjin. Praktikiqisht, pengesa për hyrjen në proceset gjyqësore para gjykatës konsiston në taksat që gazetaret duhet të paguajnë, 1% të dëmshpërblimit që kërkojnë<sup>84</sup> (p.sh. në rastet e largimit nga puna ose kur ato kufizohen, pengohen ose shoqërohen në mënyrë të paligjshme ose dhunuar nga forcat e policisë). Kjo ka bërë që disa prej tyre të kërkojnë shpërblime të vogla, të cilat nuk i përgjigjen dëmit që kanë hasur.<sup>85</sup> Vlen të theksohet se Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti” është legjislacioni i vetëm që parashikon mundësinë për t’u përjashtuar nga taksat gjyqësore dhe për të përfituar ndihmë juridike falas. Fatkeqësisht, kategoritë që janë përfituese nga ky ligj nuk përfshijnë gazetaret.

### **A sigurohet pjesëmarrja e publikut në punimet e Kuvendit? A ka kufizime ndaj gazetarëve për të ndjekur punën e Kuvendit?**

Në vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë vuri në zbatim rregullat të reja për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masmedias pranë Kuvendit, pa bërë më parë konsultime me shoqatat dhe organizatat e gazetarëve dhe punonjësve të medias, shoqërinë civile, apo aktorë të tjerë të rëndësishëm. Rregullat e reja u kufizojnë lirinë e lëvizjes gazetarëve dhe punonjësve të medias, duke ulur nivelin e transparencës në Kuvend. Gazetarët e mediave private lejohen të raportojnë vetëm nga një redaksi e caktuar dhe nuk u lejohet të raportojnë drejtpërsëdrejti nga seancat plenare apo mbledhjet e komisioneve ose të lëvizin lirshëm në të gjithë ndërtesën, siç mund

të bënin më parë. Kjo ka ngritur shqetësime për një trajtim të diferencuar të gazetarëve, ku transmetuesit publik RTSH dhe agjencisë publike të lajmeve ATSH u lejohej të kenë akses të pakufizuar, ndërkohë që mediat private janë të kufizuara.

Legjislatura aktuale e Kuvendit të Shqipërisë ka ndër-marrë hapa drejt rritjes së transparencës duke ofruar më shumë të dhëna statistikore për aktivitetin e Kuvendit. Parlamenti është angazhuar në konsultime me shoqërinë civile dhe me mediat lidhur me standardet e transparencës, të cilat pritet të miratohen.<sup>86</sup> Megjithatë, publikimi i dokumentacionit të Kuvendit, përfshirë këtu procesverbalet e seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve, ka nevojë të përmirësohet në drejtim të afateve kohore dhe lehtësisë së përdorimit të tyre. Parlamenti ka një faqe interneti të rindërtuar dhe po përpiqet të përmirësojë aksesin në informacion duke publikuar rregullisht regjistrin e kërkesave për informacion, përgjigjet dhe raportet vjetore për angazhimin me shoqërinë civile.<sup>87</sup> Mbledhjet e Komisionit Parlamentar dhe Asambleja e Përgjithshme transmetohen drejtpërdrejt në faqen zyrtare të Kuvendit në Facebook. Pavarësisht konsultimit zyrtar publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, nevojiten përpjekje të mëtejshme për rritjen e transparencës dhe aksesit në punimet e Kuvendit.

### **Sa të hapur me publikun janë qeveria dhe ministratë e saj?**

Në Shqipëri, qeveria dhe ministratë e saj nuk janë shumë të hapura me publikun. Edhe pse janë miratuar ligje për transparencën dhe aksesin në informacion, zbatimi i tyre është i paqëndrueshëm dhe shpeshherë vështirësohet së tepërmi nga pengesat burokratike. Gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile kanë raportuar vështirësi në marrjen e informacionit prej institucioneve qeveritare, veçanërisht kur kërkesat lidhen me kontratat e prokurimit dhe pagat e zyrtarëve. Krijimi kohët e fundit i AMI-t, siç u argumentua më lart, ka ngritur shqetësime për kufizimin e aksesit në informacione publike, përfshirë këtu kufizimin e mundësive që gazetaret të bëjnë pyetje kritike, praktikën e shpërndarjes së materialeve të përgatitura paraprakisht në vend të angazhimit të drejtpërdrejtë me gazetaret, dhe një numër të kufizuar të konferencave për shtyp që bëjnë të mundur një ndërveprim më konkret me gazetaret. Për më tepër, Komisioneri ka marrë një numër të madh ankesash në lidhje me aksesin në informacion, duke nxjerrë në pah nevojën për përmirësim të mëtejshme në këtë drejtim.

83 Për më shumë shih <https://rsf.org/en/albania-media-pluralism-and-transparency-concerns-fuel-deterioration-media-freedom>

84 Vendimi KLGJ Nr. 641, datë 23.12.2020 “Për propozimin për llojet dhe shkallët e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”, aksesuar <https://klgj.al/wp-content/uploads/2020/12/VENDIMI-NR-641-DAT%C3%8B-23.12.2020-MBI-PROPOZIMIN-P%C3%8BR-LLOJET-DHE-MASAT-E-TARIFAVE-GJYQ%C3%8BSORE-DHE-PROCEDUR%C3%8BN.pdf>

85 Rastet e paraqitura në gjyq në 2021 dhe 2022 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit

86 Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

87 Shih edhe: <https://www.parliament.al/>

Në nëntor 2021, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj për bashkëqeverisjen, duke i dhënë kompetenca të mëdha Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e cila më parë ishte përgjegjëse për një platformë online për ankesat e qytetarëve. Agjencia, në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit, është e autorizuar të kryejë inspektime tek institucionet publike në bazë të ankesave të qytetarëve dhe mund të propozojë masa disiplinore ose të zbatojë sanksione administrative. Megjithatë, janë ngritur shqetësime për ndikimin e mundshëm të kësaj reforme në (i) planifikimin dhe koordinimin e politikave, (ii) Kodin e Procedurave Administrative, dhe (iii) ndarjen e pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit.<sup>88</sup> Ligji është kontradiktor pasi synon gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje, rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së administratës shtetërore, nga ana tjetër rezultojnë se qeveria nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të forcuar ligjin ekzistues. mekanizma që garantojnë akses të ngjashëm siç është ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Është gjithashtu e paqartë se si mund të arrihet koncepti i bashkëqeverisjes në një mjedis ku institucionet nuk janë plotësisht transparente dhe ligji bazë që garanton aksesin e qytetarëve në informacionin nga institucionet shtetërore has një sërë problemesh. Implikimet e ligjit të ri në transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë mbeten për t'u parë dhe efektet e tij do të duhet të monitorohen nga afër.

---

<sup>88</sup> Komisioni Evropian, 2022. Raporti Vjetor për Shqipërinë, aksesuar më 25.03.2023 në adresën <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

## **B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve**

---

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontratën e punës? A u paguhen të plota sigurimet shoqërore e shëndetësore? Sa të mira janë pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

---

Në vitin 2022, nuk ka pasur përmirësime për të drejtat në punë të gazetarëve në Shqipëri. Pavarësisht se për pjesën më të madhe të gazetarëve në Shqipëri janë hartuar kontrata formale pune, vazhdojnë të hasen sfida me zbatimin e të drejtave në punë. Këto sfida lidhen me vonesën e pagave, marrjen e pagave në rrugë informale, parregullsi në sigurimet shoqërore, mungesa e pushimeve javore/vjetore, orët e gjata të punës dhe çështjen e pushimit nga puna në kundërshtim me ligjin. Në një raport të vitit 2022 theksohet se në mënyrë të veçantë gazetarët e reja që punojnë për mediat online nuk kanë kontrata të rregullta pune, ndërkohë që vonesat apo rregullsia e pagësave janë një shqetësim për gazetaret, mediat online dhe mediat lokale.<sup>89</sup> Këto gjetje sugjerojnë se nuk mjaftojnë vetëm kontratat e ligjshme për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave në punë. Nevojiten reforma për të forcuar mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe për të përmirësuar zbatimin e ligjeve në fuqi me qëllim për të siguruar kushte më të mira pune për gazetarët në Shqipëri.

---

<sup>89</sup> Studimi nga 'Lajmetarja', 2023, në adresën <https://lajmetarja.al/wp-content/uploads/2023/03/Gjetjet-kryesore-raport-final-Mars-2023-1.pdf>

Dallimet e konsiderueshme në nivelin e pagave të gazetarëve dolën në dritë par rrjedhjes së të dhënave që evidentuan disnivele të mëdha të pagave mes punonjësve të medias.<sup>90</sup> Ndërkohë që disa prezantues, producentë dhe gazetarë marrin paga të frikshme që arrijnë deri në 20 mijë euro në muaj, shumë të tjerë paguhën me pagë minimale. Këto dallime nxjerrin në pah praninë e praktikave joformale në industrinë e medias dhe intervistat dhe fokus grupet me gazetarët sugjerojnë se paga mesatare është rreth 500 euro në muaj, sa dyfishi i pagës minimale. Kjo pabarazi në paga jo vetëm që përjetëson pabarazinë në të ardhura, por rrezikon të komprometojë pavarësinë dhe integritetin e gazetarisë, duke qenë se presionet financiare dhe praktikat informale mund të ndikojnë në raportimin e lajmeve. Prandaj është e nevojshme që industria e medias dhe institucionet rregullatore të sigurojnë transparencë dhe drejtësi në praktikat e pagave, gjë që do të promovojë një sektor më të drejtë dhe më profesional gazetarie.

### **Në ç'gjendje janë kushtet e punës së gazetarëve? Cilat janë problemet më të mëdha që hasin në vendin e punës?**

Kushtet e punës së gazetarëve kanë mbetur përgjithësisht të pandryshuara edhe në vitin 2021, ku vazhdojnë problemet me mosrespektimin e Kodit të Punës, mungesën e sigurisë dhe shkeljen e të drejtave të autorit.

Në vitin 2022, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network) ishte dëshmitar i një sërë rastesh të shkeljeve të të drejtave të gazetarëve në Shqipëri. Në janar të vitit 2023 ky rrjet në Shqipëri mori raportime nga gazetarë dhe punonjës të mediave të RTSH-së që tregonin për pushime nga puna për shkak të ristrukturimit të strukturës së RTSH-së pas ardhjes së drejtorit të ri të përgjithshëm. Ndonëse Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë stafin e RTSH-së, siç parashikohet në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" (neni 103 dhe 105), ato duhen bërë me transparencë të plotë dhe në respektim të të drejtave të punës së gazetarëve. SafeJournalists kërkoi informacione për numrin e gazetarëve dhe punonjësve të medias të pushuar nga puna, por RTSH u përgjigj duke deklaruar se të gjitha procedurat janë ndjekur sipas Kodit të Punës dhe asnjë gazetar nuk është pushuar nga puna. Pavarësisht rasteve të shumta të raportuara, asnjë punonjës i medias apo gazetar nuk doli publikisht për të folur për këto çështje. Ngurrimi për të bërë një gjë të tillë ka të ngjarë të vijë nga frika e ndëshkimit dhe prej dëshirës për të ruajtur vendin e punës në një sektor të vështirë si media.

Në muajt e fundit të vitit 2022, SafeJournalists mori raportime nga stafi i medias së Euronews Albania në lidhje me shkarkimin e supozuar të rreth 30 punonjësve si rezultat i ndryshimit të drejtuesve të kësaj medie. Pjesa më e madhe e personelit të prekur u detyruan të jepnin dorëheqjen, ndërkohë që një numër i vogël punonjësish u pushuan menjëherë nga puna. Jetmira Kaçi, ish producente ekzekutive me kontratë të përhershme pune, pohoi publikisht se shkarkimi i saj u bë pa arsye të ligjshme. Ajo është njëra nga një numër i vogël punonjësish të medias që kanë dalë publikisht dhe kanë nisur procedurat ligjore. Ekzistenca e mundshme e presioneve jozyrtare ndaj gazetarëve dhe frika nga ndonjë hakmarrje profesionale duket se kanë penguar një numër të madh punonjësish për të dalë publikisht dhe për të raportuar raste të ngjashme të shkarkimeve të paligjshme apo dorëheqjeve të detyruara. Duhet theksuar se Inspektorati i Punës nuk ka raportuar asnjë problem tek Euronews Albania. Kundërshtitë mes raportimeve kontradiktore nga gazetarët dhe informacioneve nga autoritetet publike e kanë bërë situatën edhe më të ndërlikuar.

Për më tepër, edhe disa organe të tjera mediatike, si FaxNews, Oranews dhe RTV Ora, janë përballur me vështirësi të mëdha gjatë vitit të kaluar. FaxNews pati vonesa të konsiderueshme me pagat e gazetarëve dhe stafit të medias, një situatë që u krijua pas vdekjes së pronarit dhe për shkak të vështirësive serioze financiare me të cilat përballej media. Po ashtu, Oranews dhe RTV Ora kanë pasur vonesa me pagesat e personelit. Madje RTV Ora u sekuestrua nga shteti si pasojë e zbatimit të ligjit antimafia ndaj pronarit.

Këto incidente nxjerrin në pah nevojën për transparencë, llogaridhënie dhe respektim të të drejtave të punë në industrinë e medias dhe është përgjegjësi e pronarëve të mediave, institucioneve rregullatore dhe qeverisë për të siguruar një mbrojtje të tillë. Megjithatë, të këto institucione raportohen një numër i vogël rastesh. Të dhënat e marra pas një kërkesë për informacion drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore tregojnë se në vitin 2022, vetëm gjashtë ankesa ishin bërë pranë këtyre institucioneve nga gazetarë apo punonjës të medias. Këto ankesa kishin të bënin kryesisht me probleme të hasura në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, vonesa ose mospagim të pagave apo kontributeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe shkelje në marrëdhëniet e punës. Nga të dhënat rezulton se ankesat janë zgjidhur në favor të punonjësve ku janë konstatuar shkelje dhe janë zgjidhur gjatë procedurës së inspektimit.<sup>91</sup> Për më tepër, Inspektorati konfirmon se kompanitë e mediave janë në zonën gri të informalitetit për shkak të problemeve me

<sup>90</sup> Për më shumë informacione për rrjedhjen e madhe të të dhënave shih adresën <https://balkaninsight.com/2021/12/22/albanian-prosecutors-probe-huge-suspected-leak-of-personal-data/>

<sup>91</sup> Përgjigja e marrë pas kërkesës për informacion dërguar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janar 2023.

marrëdhëniet dhe kushtet e punës. Për rrjedhojë, këto subjekte do të vazhdojnë të inspektohen në kuadër të planit të riskut me “Informalitetin Gri” për përmirësimin e respektimit të Kodit të Punës.<sup>92</sup>

Përveç këtyre vështirësive, gazetarët po përballen gjithnjë e më shumë me kërcënime të sigurisë dixhitale, përfshirë këtu hakerimin, peshkimin kibernetik (phishing) dhe përgjimin. Gazetarët që punojnë për mediat online janë veçanërisht të cenueshëm për shkak të përhapjes së informalitetit në marrëdhëniet e punës. Mungesa e kontratave të ligjshme mund të vështirësojë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe ndërtimin e profilit profesional të gazetarëve. Në vitin 2021, në Shqipëri pati rrjedhje të mëdha të të dhënave personale dhe në vitin 2022 nga një sulm masiv kibernetik në Shqipëri u shkaktua publikimi i të dhënave të tjera personale të qytetarëve, përfshirë këtu edhe llogaritë bankare. Kjo ka ngritur shqetësime për sigurinë dhe privatësinë e gazetarëve si dhe të burimeve të tyre apo edhe për aftësinë e mediave për të mbrojtur të dhënat e tyre konfidenciale. Si rezultat, del në pah përherë e më shumë nevoja që gazetarët t’i japin përparësi sigurisë dixhitale dhe që mediat të zbatojnë masa më të mira të sigurisë kibernetike për të mbrojtur punonjësit dhe të dhënat e tyre.

## **B2 Pavarësia editoriale në mediat private**

**A kanë të miratuara mediat private rregulla organizative sipas të cilave redaksitë janë të ndara dhe të pavarura nga drejtuesit dhe drejtorja e marketingut?**

Në vitin 2022, nuk ka pasur ndonjë përmirësim të dukshëm në pavarësinë editoriale të mediave private në Shqipëri. Burimet e kufizuara shpesh bëjnë që të njëjtët individë të mbulojnë shumë role, gjë që vështirëson ndarjen e qartë mes redaksisë dhe funksioneve të menaxhimit/marketingut. Ndonëse pak media të mëdha private kanë të miratuar rregulla organizative për të garantuar pavarësinë editoriale, kjo gjë nuk zbatohet gjithmonë në praktikë. Mediat partizane dhe lidhjet mes pronarëve të mediave dhe politikës, interesave të biznesit dhe kimit të organizuar vazhdojnë të minojnë pavarësinë editoriale.

**A kanë miratuar mediat rregulla të tjera për të ruajtur pavarësinë editoriale nga pronarët dhe organet drejtuese? A respektohen këto rregulla?**

Pavarësia editoriale është një tregues i qartë i integritetit të medias dhe kusht themelor për besimin te media dhe përmbajtja cilësore është jashtëzakonisht e pasigurt në Shqipëri. Në Shqipëri, gjithsesi, pavarësia editoriale mbetet e pasigurt, dhe mediat private me më shumë ndikim zotërohen nga një pjesë e vogël kompanish, të cilat kanë lidhje me politikanë. Këto kompani në të njëjtën kohë operojnë në sektorë shumë të rregulluar, të tilla si ndërtimi, gjë që mund të komprometojë më tej pavarësinë editoriale. Ndonëse pak media të mëdha private kanë të miratuar, të paktën në letër, rregulla organizative për të siguruar pavarësinë editoriale, në praktikë kjo e fundit shpesh komprometohet nga mediat e njëanshme, lidhjet e pronarëve të mediave me politikën, interesat e biznesit dhe madje edhe lidhjet me krimin e organizua. Nuk ka transparencë proaktive në lidhje me pronësinë e mediave dhe pavarësinë editoriale në pjesën më të madhe të mediave private.

**A kanë redaksitë e lajmeve të mediave private kode të brendshme etike apo a respektojnë ato një kod të përgjithshëm etike?**

Mediat private në Shqipëri vazhdojnë të mbështeten në kodet e jashtme të etikës dhe jo në politikën e tyre të brendshme. Ndonëse nuk ka ndonjë ndryshim të madh në këtë praktikë në krahasim me vitin e kaluar, kjo mungesë përbën shqetësim pasi bën redaksitë të mos kenë udhëzime të qarta dhe të përshtatshme për të siguruar respektimin e standardeve etike. Kodi i Etikës i hartuar nga Këshilli Shqiptar i Medias përdoret shpesh si pikë referimi, por respektimi i tij është vullnetar dhe jo të gjitha mediat i zbatojnë rekomandimet e tij.<sup>93</sup> Për më tepër, respektimi i standardeve etike mund të cenohet nga presionet e jashtme, përfshirë këtu interesat politike dhe ekonomike. Kështu, pa një kod të brendshëm etike të konsoliduar dhe të brendësuar, pavarësia editoriale dhe besueshmëria e mediave private mund të vihet në rrezik.

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron mbi redaksitë apo mbi gazetarët të caktuar?**

Pronarët dhe drejtuesit e mediave në Shqipëri njihen për përdorimin e taktikave të ndryshme për të ndikuar

92 Po aty.

93 Këshilli Shqiptar i Medias, “Kodi i Etikës për Gazetarët në Shqipëri”. Aksesuar më 15.3.2021. <https://kshm.al/en/code-of-ethics-for-journalists/>

në linjën editoriale të mediave të tyre. Një nga format më të zakonshme të presionit është mbyllja e emisioneve ose mostransmetimi i kronikës së përgatitur nga gazetarët nëse ato bien ndesh me interesat e pronarit të medias apo të aleatëve të tij politikë ose të biznesit. Kjo ka çuar në vetë-censurë tek gazetarët, të cilët kanë frikë të raportojnë për çështje të ndjeshme nga frika e hakmarrjes. Përveç mbylljes së emisioneve ose mostransmetimit të kronikave, pronarët dhe menaxherët e mediave mund të përdorin edhe taktikën e kërcënimit për të ushtruar presion ndaj gazetarëve. Kërcënimet bëhen në formë verbale ose fizike ashtu si edhe ngacmimet, të cilat krijojnë një mjedis armiqësor pune për gazetarët.

Pasiguria ekonomike është një tjetër taktikë që përdoret shpesh nga pronarët dhe drejtuesit e mediave. Gazetarët mund të kërcënohen me humbje të punës ose t'u mbahet paga nëse nuk respektojnë linjën editoriale të vendosur nga pronari i medias. Kjo mund të çojë në vetë-censurë ose mungesë të raportimit kritik për çështje të caktuara. Kontrolli mbi përmbajtjen dhe detyrimi për të bërë kronikën në një formë të caktuar është një formë tjetër presioni që pronarët dhe drejtuesit e mediave ushtrojnë tek redaksitë e tyre. Pronarët dhe drejtuesit e mediave i udhëzojnë gazetarët të raportojnë për një çështje të caktuar në një formë të përcaktuar ose ta paraqesin atë sipas një këndvështrimi të caktuar. Kjo mund të komprometojë objektivitetin dhe pavarësinë e redaksisë dhe të çojë në raportim të njëanshëm. Në raste ekstreme, pronarët dhe drejtuesit e mediave mund të përdorin shantazhe për t'i bërë presion gazetarëve që të përmbushin dëshirat e tyre. Disa nga format e presionit janë kërcënimet për publikimin e informacionit personal ose materialeve të tjera konfidenciale nëse gazetari nuk përmbush kërkesat e pronarit.

**Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga pronarët apo drejtuesit e mediave mbi një redaksi të tërë ose gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?**

Në vjeshtën e vitit 2022, ABC News ndryshoi pronarë, gjë që shkaktoi ndryshim edhe në linjën editoriale të medias në mbështetje të partisë politike në pushtet. Si rezultat i këtij ndryshimi, tre emisione, Piranjat (investigative), LOG (talk show), dhe VETING (analizë, investigim) u mbyllën dhe shumë gazetarë u detyruan të jepnin dorëheqjen ose panë të mbylleshin programet e tyre. Enkel Demi, një gazetar i respektuar, foli që atëherë për ndikimin e këtyre ndryshimeve, duke deklaruar publikisht se tashmë ndihej i "izoluuar" dhe pa miq, pasi shumë nga ish kolegët e tij ishin pushuar nga puna. Po ashtu, më 5 dhjetor, gazetari Endri Xhafo njoftoi në rrjetet sociale se programi i tij "Log" nuk do të transmetohej më në ABC News me efekt të menjëhershëm, si pjesë e asaj që u cilësua si nismë për "ristrukturim programi".

### **B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik**

**A ka të miratuar një kode sjelljeje për gazetarët dhe pavarësi editoriale transmetuesi i shërbimit publik? A e respektojnë gazetarët këtë kod?**

Transmetuesi i Shërbimit Publik (TSHP) është i detyruar me ligj të ketë një kod sjelljeje dhe kod etike të miratuar<sup>94</sup> si dhe të sigurojë pavarësinë editoriale.<sup>95</sup> Vitet e fundit, TSHP ka marrë pjesë në projekte të ndryshme të financuara nga donatorët, projekte që synojnë ngritjen e kapaciteteve dhe pavarësinë editoriale të gazetarëve. Në vitin 2020, ky transmetues publikoi online politikën editoriale, ku përcaktohen parimet kryesore të pavarësisë editoriale, përfshirë kodin e etikës dhe standardet profesionale.<sup>96</sup> Megjithatë, në praktikë, ka ende shqetësime se TSHP perceptohet se favorizon partinë në pushtet në punën e saj mediatike, me gjithë progresin e arritur në shndërrimin e tij në një media që i shërben publikut. Është e rëndësishme të theksohet se respektimi nga gazetarët i kodit të sjelljes dhe etikës të TSHP-së është me rëndësi të madhe për të bërë të mundur promovimin e pavarësisë editoriale dhe raportimit të paanshëm në këtë media.

**A kanë organet e TSHP rregulla të brendshme organizative për ta siguruar pavarësinë e redaksisë nga organet drejtuese të TSHP-së? A respektohen këto rregulla?**

TSHP supozohet se e ka të ndarë redaksinë e lajmeve nga organet drejtuese, siç përcaktohet në Ligjin për Mediat Audiovizive të vitit 2013. Këshilli Drejtues, që është organi më i lartë drejtues, është përgjegjës për mbikëqyrjen e TSHP-së, Drejtori i Përgjithshëm mbikëqyr menaxhimin e përditshëm dhe Bordi i Administrimit është bord këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm për çështje financiare dhe administrative, por që nuk lidhen me programin dhe përmbajtjen. Këto struktura janë krijuar të sigurojnë pavarësinë e redaksisë dhe respektimin e politikës editoriale, kodit të etikës dhe standardeve profesionale. Megjithatë, në praktikë, dihet që

94 Neni 97/4 i ligjit për mediat audiovizive

95 Neni 101, germa "c" e ligjit për mediat audio-vizive parashikon që anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë pavarësinë e RTSH-së në lidhje me krijimin, prodhimin dhe përmbajtjen e materialeve programore, hartimin dhe paraqitjen e emisioneve informative dhe çështjeve me interes publik dhe mosndërrimja e shtetit, politikës dhe biznesit në këto aktivitete.

96 Kodi i etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale të RTSH gjenden në adresën: [https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/4fe8d4a805a246d7a33ff6dc658036e9\\_202004071647.pdf](https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/4fe8d4a805a246d7a33ff6dc658036e9_202004071647.pdf)

drejtuesit ndikojnë në punën e redaksisë dhe të gazetarëve.

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron mbi redaksitë apo mbi gazetarët e Transmetuesit të Shërbimit Publik?**

Ndikimi i qeverisë është i tërthortë dhe lidhet me perceptimin që RTSh favorizon partinë në pushtet për sa i përket mbulimit që i bëhet duke qenë se Këshilli Drejtues zgjidhet me votat e shumicës në Kuvend.

**Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga qeveria mbi të gjithë redaksinë ose te gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?**

Shqetësimet kryesore nuk kanë të bëjnë me presionin e drejtpërdrejtë nga qeveria, por më shumë nga marrëdhëniet e ndërlikuara dhe të pleksura mes drejtuesve të TSHP, politikanëve dhe interesave të tjera të fuqishme. Nga ana tjetër, qeveria ushtron presion të tërthortë ndaj gazetarëve, duke e denigruar gazetarinë profesionale, duke ndërmarrë fushata shpifjeje dhe duke bërë retorikë kundër mediave. Forma të tjera janë paditë për shpifje dhe kërcënimet me padi ligjore kundër gazetarëve investigativë si dhe shkelja e të dhënave dhe thyerja e sigurisë dixhitale.

#### **B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse**

**A kanë të miratuar mediat jofitimprurëse një kod sjelljeje dhe të pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respektojnë gazetarët këtë kod?**

Mediat jofitimprurëse në Shqipëri kanë një ecuri më të mirë të pavarësisë editoriale në krahasim me mediat fitimprurëse. Këtu bëjnë pjesë mediat investigative, mediat fakt-verifikuese dhe zakonisht mediat të orientuara drejt misionit që i shërbejnë komunitetit. Për të siguruar pavarësinë editoriale, ato kanë të miratuar kodin e sjelljes së gazetarëve, të cilën këta të fundit e respektojnë. Këto media prirën të përdorin Kodin e Etikës të botuar nga Instituti Shqiptar i Medias dhe të rishikuar në vitin 2018 dhe Këshilli Shqiptar i Medias ishte pjesë e grupit të punës dhe respekton po këtë kod.<sup>97</sup>

<sup>97</sup> Kodi i Etikës gjendet në adresën <https://kshhm.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikes-final-shqip-3.pdf>

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit mbi mediat jofitimprurëse?**

Në Shqipëri mediat jofitimprurëse janë më të pakta në numër dhe më të vogla për sa i përket madhësisë në krahasim me mediat fitimprurëse private. Këto media përballen me vështirësi që lidhen me lirinë e medias, qëndrueshmërinë financiare dhe sigurinë. Shembull i formave më të zakonshme të presionit ndaj mediave jofitimprurëse janë mungesa e fondeve për prodhimin dhe zgjerimin e përmbajtjes. Shpesh përdoren edhe Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (që njihen me termin “Paditë SLAPP”) me anë të të cilave bëhen përpjekje për të frikësuar dhe dekurajuar raportimin investigativ. Një tjetër pengesë që haset nga mediat jofitimprurëse është mungesa e aksesit tek informacioni publik që ka të bëjë me transparencën e kufizuar të institucioneve publike dhe me frikësimin e gazetarëve.

**Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar mbi mediat jofitimprurëse?**

Në vitin 2022, nuk ka shembuj të mirëfilltë të presionit të ushtruar ndaj mediave jofitimprurëse. Shembulli më i njohur mbetet padia SLAPP kundër gazetarëve të BIRN në dhjetor 2020 dhe kundër reporterit lokal Artan Rama, shembuj që janë dhënë në raportin e vitit të kaluar.

#### **B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve**

**Sa liri kanë gazetarët në përzgjedhjen e lajmeve për të cilat punojnë dhe për të vendosur se cilin aspekt të lajmit duhet të nxjerrin në pah?**

Pavarësia editoriale dhe liria e shtypit janë me rëndësi të jashtëzakonshme për një demokraci funksionale dhe për të siguruar që publiku të marrë informacione të sakta dhe të besueshme. Megjithatë, në Shqipëri, gazetarët shpesh përballen me vështirësi kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e lajmeve, pasi zgjedhjet e tyre mund të bien ndesh me interesat e pronarëve të mediave, figurave politike apo individëve të tjerë me pushtet. Politika editoriale e organeve mediatike, pozicioni i redaksisë përkundër atij të pronarëve dhe drejtuesve, si dhe për strukturën e pronësisë së medias dhe të ardhurat janë faktorë të tjerë që ndikojnë në lirinë e gazetarëve për të përzgjedhur lajmet ose kronikat e tyre. Po ashtu, vetë-censurimi mbetet problem mjaft i përhapur në industri, ku shumë gazetarë zgjedhin të fshehin disa aspekte të historive ose të ndryshojnë përmbajtjen për të

shmangur reagimin ose dëmtimin e mundshëm ndaj vetes ose mediave të tyre. Pavarësisht përpjekjeve për të luftuar vetë-censurën dhe për të nxitur pavarësinë editoriale, kjo praktikë vazhdon të dominojë në mjedisin e mediave në Shqipëri. Është me rëndësi të madhe të krijohet dhe forcohet kultura e gazetarisë së pavarur për të mbështetur vlerat e demokracisë dhe për të mbrojtur të drejtën e publikut për t'u informuar në mënyrë të saktë dhe të besueshme.

### **Sa shpesh marrin pjesë në takime koordinuese editoriale të redaksive (pjesëmarrjen në takimet e redaksisë apo caktimi i reporterëve)?**

Në vitin 2022, kemi të njëjtën tendencë ku gazetarët marrin pjesë çdo ditë në të paktën një takim koordinues të redaksisë, ku vendosen historitë/temat që do të trajtohen. Ndonëse kjo procedurë vlen për pjesën më të madhe të mediave, për ato të vogla e private, gazetarët nuk bëjnë mbledhje kaq formale, por bëjnë takime informale të atypëratyshme. Nga ana tjetër, portalet e mediave online, të cilat funksionojnë në anonimitet, situata është e ndryshme ku kemi përmbajtje shumë të pakët origjinale dhe pak lajme të prodhuara nga vetë ata. Në fakt, stafi i tyre punon kryesisht me copy/paste lajmesh ose përkthim nga portale apo media të tjera të huaja, gjë që është një tjetër tregues i përkeqësimit të cilësisë dhe raportimit të medias dhe shkelje e qartë e të drejtave të autorit.

### **Cili është qëndrimi i gazetarëve në lidhje me etikën e gazetarëve?**

Gazetarët në Shqipëri në përgjithësi e pranojnë rëndësinë e respektimit të Kodit të Etikës dhe janë në favor të forcimit të zbatimit të tij. Gjithsesi, jo të gjithë gazetarët kanë kapacitetet dhe janë të ndërgjegjësuar për të respektuar këtë kod dhe në shumë raste mungon trajnimi i vazhdueshëm për etikën në raportim. Edhe pse mund të kenë qëllime të mira, gazetarët ndonjëherë nuk përmbushin standardet etike, veçanërisht kur mbulojnë raste të ndjeshme sociale ku bëhet fjalë për drama, dhunë dhe konflikte. Kjo mund të shkaktojë shqetësime dhe minon besueshmërinë e medias dhe besimin në të. Për më tepër, ka raste kur pronarët dhe drejtuesit e mediave u bëjnë presion gazetarëve që t'i japin përparësi sensacionalizimit dhe jo etikës në raportim, duke dëmtuar edhe më shumë integritetin e gazetarisë. Prandaj, është e rëndësishme që organizatat e medias dhe shoqatat e gazetarëve t'i japin përparësi trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm për etikën në raportim për të garantuar respektimin e standardeve të larta të gazetarisë.

### **Cilat janë vetë-perceptimet e gazetarëve për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe të burimeve të ndryshme të ndikimit?**

Sipas vlerësimit, gazetarët janë të ndërgjegjësuar për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe burimeve të ndikimit, veçanërisht për sa i përket sigurisë, presioneve nga qeveria dhe formave të tjera të kërcënimit nga pronarët. Si rezultate, vetë-censurë është bërë praktikë normale mes gazetarëve në Shqipëri. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjithë gazetarët kanë të njëjtin kapacitete apo njohuri për standardet dhe kodet etike dhe mungon trajnimi i vazhdueshëm në këtë fushë. Disa gazetarë përdorin praktika joetike raportimi, veçanërisht kur mbulojnë çështje sociale me dramë, dhunë dhe konflikt.

### **Sa gazetarë raportojnë censurë nga redaktorët? Sa gazetarë raportojnë se iu nënshtruan vetë-censurës për shkak të kërcënimit apo humbjes së vendit të punës ose për shkak të rreziqeve të tjera?**

Në vitin 2022, censura dhe vetë-censura vazhdojnë të jenë problem i madh në mjedisin mediatik në Shqipëri ashtu si edhe në vitet e kaluara. Nga studimet konfirmohet se motivet kryesore të censurës dhe vetë-censurës vijnë nga presionet politike dhe ekonomike, mungesa e qëndrueshmërisë financiare të mediave, mungesa e profesionalizmit dhe mungesa e etikës dhe e respektimit të të drejtave të gazetarëve.

Censura dhe vetë-censura në Shqipëri janë më të zakonshme në mediat audiovizive dhe në organet e shtypit që kontrollohen nga një pjesë e vogël e familjeve të fuqishme, të cilat kanë lidhje biznesesh në tregjet e rregulluara. Përqendrimi i pronësisë së medias në duart e disa individëve dhe familjeve ka krijuar një mjedis ku mediat shpesh përdoren si mjete për të përmbushur interesat politike ose të biznesit, në vend që t'i shërbejnë interesit publik.

Gazetarët vihen nën presion të vazhdueshëm nga pronarët, redaktorët dhe politikanët për të shmangur tema të caktuara dhe për të ndjekur një linjë të njëanshme editoriale dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira me qeverinë apo me interesat e biznesit. Kjo vetë-censurë përbën një kërcënim të madh për lirinë e shtypit dhe për aftësinë e gazetarëve për të bërë raportim të paanshëm dhe të saktë. Për më tepër, gazetarët përballen me probleme të sigurisë fizike gjatë raportimit, veçanërisht gjatë krizave, të tilla si fatkeqësitë natyrore dhe protestat. Ka pasur raportime ku gazetarët janë sulmuar fizikisht dhe janë kërcënuar gjatë mbulimit të protestave apo çështjeve të tjera të ndjeshme. Shqetësim i madhe



mbeten edhe mungesa e masave të sigurisë dhe dështimi i autoriteteve ligjzbatuese për të garantuar sigurinë e gazetarëve.

Nga ana tjetër, mediat online janë më të larmishme dhe bëjnë të mundur një nivel më të lartë pavarësie editoriale. Shumë media online janë në hapat e parë dhe në disa raste drejtohen nga gazetarë profesionistë, të cilët u japin më shumë përparësi integritetit dhe pavarësisë në gazetari. Si të tilla, këto media u ofrojnë më shumë mundësi gazetarëve të raportojnë histori nga perspektiva të shumta dhe pa të njëjtin nivel presioni nga pronarët ose interesat e jashtme. Megjithatë, edhe mediat online kanë problemet e tyre, si qëndrueshmëria financiare dhe kërcënimet për sigurinë dixhitale.

## **B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare**

**A punojnë gazetare femra në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre meshkuj? A kanë nënshkruar kontrata pune po aq shpesh sa edhe burrat?**

Në Shqipëri, gratë gazetare shpesh raportojnë kushte më të këqija pune se kolegët e tyre meshkuj. Në vitin 2022, ka dalë në plan të parë problemi i diskriminimit me bazë gjinore dhe i ngacmimeve në vendin e punës, ku gratë e gazetarisë kanë ngritur shqetësime për ngacmimet seksuale dhe dhune online apo disinformim për shkak të gjinisë.<sup>98</sup> Pavarësisht numrit të madh të rasteve në fjalë, nuk ka pasur raportime tek autoritetet për raste të tilla dhe gratë gazetare hezitojnë të dalin publikisht nga frika e hakmarrjes. Kjo nxjerr në pah nevojën për mbështetje dhe mbrojtje më të madhe për gratë gazetare në Shqipëri, përfshirë këtu përmirësimin e mekanizmeve të raportimit dhe masave për të parandaluar dhe trajtuar diskriminimin dhe ngacmimin me bazë gjinore në vendin e punës.

**A priren gratë të mbajnë pozicione drejtuese editoriale në redaksi po aq sa edhe burrat?**

Edhe pse gratë përfaqësojnë numrin më të madh të gazetarëve në Shqipëri, shumë pak prej tyre kanë poste drejtuese në redaksi. Ky pabarazi e theksuar gjinore është e pranishme edhe në proceset vendimmarrëse

në media. Një tjetër **çështje që lidhet me mungesën e barazisë gjinore në sektorin e medias është mungesa e të** dhënave të ndara sipas gjinisë. Pa të dhëna të sakta është e vështirë të matet progresi dhe të identifikohen fushat që kërkojnë më shumë vëmendje dhe burime. Kjo mungesa të dhënash e bën më të vështirë zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë të trajtojnë diskriminimin me bazë gjinore dhe të promovojnë barazinë gjinore në sektorin e medias.

**Sa të larta janë pagat e tyre në krahasim me ato të meshkujve?**

Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë për pagat e gazetarëve në Shqipëri e bën të vështirë vlerësimin e saktë të shkallës së hendekut gjinor në paga në industrinë e medias. Megjithatë, sipas raportimeve dhe fokus grupeve me gazetarë, gazetarët femra shpesh paguhën më pak se homologët e tyre meshkuj për të njëjtën punë. Ky është një problem i madh, sepse jo vetëm përjetëson pabarazinë gjinore në vendin e punës, por ndikon edhe në fuqizimin ekonomik të grave gazetare. Hendeku gjinor i pagave ka të ngjarë të kontribuojë edhe në përfaqësim më të ulët të grave në poste drejtuese në media. Është me rëndësi të mblidhen dhe të analizohen të dhënat e ndara sipas gjinisë për pagat për ta trajtuar këtë çështje dhe për të nxitur barazinë gjinore në industrinë e medias.

**A bëhen ato subjekt i presioneve të caktuara për shkak të gjinisë?**

Gratë gazetare në Shqipëri vazhdojnë të raportojnë ngacmime seksuale, dhunë online dhe fushata shpifjesh si format më të zakonshme të presioneve me bazë gjinore me të cilat përballen. Shpesh, këto presione nuk denoncohen ku shumë gra gazetare mendojnë se ankesat e tyre nuk do të merren seriozisht apo se do të përballen me hakmarrje për denoncimet që bëjnë. Për më tepër, ka rritje të rasteve shqetësuese të disinformimit për shkak të gjinisë dhe dhunës online ndaj grave gazetare. Gazetarët femra kanë raportuar se kanë marrë një numër tejet të madh të komenteve mizogjene dhe kërcënuese në platformat e mediave sociale, ku disa komente janë tërësisht të dhunshme ose me konotacione seksuale. Ky lloj ngacmimi dhe disinformimi online mund të jetë veçanërisht i dëmshëm për karrierën e femrave, sepse mund t'i dekurajojë ato që të mos ndjekin histori të caktuara apo të marrin role të caktuara në industrinë e medias.

<sup>98</sup> Lajmëtarja (2023), "Gazetarët shqiptarë - Suksese dhe sfida: Prezantimi i situatës së gazetareve shqiptarë në peisazhin mediatic", aksesuar më 31.03.2023 në adresën <https://lajmetarja.al/wp-content/uploads/2023/03/Gjetjet-kryesore-raport-final-Mars-2023-1.pdf>



## C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë

---

Rrjeti “Gazetarët e sigurt” ka regjistruar dhe raportuar 18 raste sulmesh kundër gazetarëve.

### Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike

Në vitin 2022 janë raportuar disa incidente, mes të cilave edhe rasti i zj. Kostani, punonjëse policie në Drejtorinë e Policisë së Elbasanit, e cila ofendonte publikisht gazetarët në rrjetet sociale, duke pretenduar se po pengonin punën e policisë vendore. Kreu i Policisë, Gledis Nano, e pezulloi oficeren Kostani dhe nisi hetimet për veprimet e saj ndaj gazetarëve.<sup>99</sup> Në një tjetër incident, kryeministri Edi Rama e deklaroi publikisht Klevin Mukën, gazetar i stacionit televiziv A2 CNN, si të padëshiruar në konferencat e ardhshme për shtyp, sepse gazetari i bëri një pyetje për konfliktin e interesit të Ministres së Jashtme dhe për përfshirjen e bashkëshortit të saj si investitor strategjik në sektorin e turizmit të qeverisë. Rama e akuzoi Mukën për sjellje joetike dhe urdhëroi dërgimin e tij për riedukim.<sup>100</sup>

---

<sup>99</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/threats-against-media-by-police-officer-kostani-19-08-2022-elbasan/>

<sup>100</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/other-threats-to-journalists-kelvin-muka-tirana-01-07-2022/>

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<b>Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike</b> – Në kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike bëjnë pjesë: – Mbikëqyrje ose ndjekje; – Ngacmim me thirrje telefonike; – Ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ; – Deklarata agresive nga zyrtarë publikë; – Forma të tjera presioni që mund të vënë në rrezik sigurinë e gazetarëve në vijimin e punës. Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë rrethimin apo bulizmin në mjedisin e punës.	6 (1 F, 4 M, 1 përgjithshme)	– Një punonjëse policie në Drejtorinë e Policisë së Elbasanit, zj. Kostani, ofendoi publikisht gazetarët në rrjetet sociale, gjë që çoi në pezullimin e saj dhe nisjen e hetimeve nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, z. Gledis Nano, në të njëjtën ditë, më 19 gusht. – Kryeministri Edi Rama ndaloi gazetarin Klevin Muka të marrë pjesë në konferencat e ardhshme për shtyp për tre muajt në vazhdim dhe e urdhëroi atë të “riedukohej”, sepse ky i fundit gjatë një konference për shtyp më 1 korrik i bëri një pyetje për konfliktin e interesit të ministres Olta Xhaçka. – Gazetari Isa Myzyraj është përballur me presione dhe kërcënime për shkak të raportimit nga ana e tij të procesit të vetingut të Kryetares së Prokurorisë së Tiranës, Elizabeta Imeraj. – Një noter publik nxori certifikatën familjare dhe faturën e pagesave nga portali e-Albania për gazetarin Edmond Hoxhaj dhe bashkëshorten e tij pa dijeninë apo pëlqimin e këtyre të fundit. – Gjatë seancës gjyqësore “Dosja 184”, gjyqtar veprui si kryeredaktor dhe censuroi raportimin e një reporterit të BIRN-it, duke i treguar atij se si duhet raportuar rasti. – Gjatë një konference të improvizuar shtypi më 30 mars 2022, Kryeministri Edi Rama i tha gazetares Ambrozia Meta të TV <a href="http://Syri.net">Syri.net</a> se ajo kishte nevojë për “riedukim” dhe refuzoi të merrte pyetje prej saj për 60 ditë për shkak të asaj që ai e konsideronte sjellje joprofesionale.
<b>Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve</b> Këtu përfshihen: – Kërkesa për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; – Kërkesa për dëmtime fizike kundër gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; Këto kërcënime mund të: – Bëhen drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet palëve të treta; – Dërgohen me komunikim elektronik ose ballë për ballë; – Jenë të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara.	1 rast kundër ekipit të medias (1 F dhe 1 M)	– Gjatë raportimit të emisionit investigativ Fiks Fare për asgjësimin e pulave të ngordhura nga kompanitë e rritjes të shpendëve në Durrës, përfaqësues të kompanisë Orbital thyen kamerën e kameramanit dhe kërcënuan gazetarin teksa këta të fundit ishin duke kryer detyrën e tyre.
<b>Sulme faktike ndaj gazetarëve</b> Llojet e sulmeve faktike mund të jenë dëmtimet fizike ose mendore, rrëmbimet, dhunimi i shtëpisë/zyrave, sekuestrimi i pajisjeve, ndalimi arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj.	9 sulme faktike (6 M, 3F)	– Në janar, gazetari i TV Rozafa dhe ABC News, Simon Shkreli, u ndalua nga një punonjës policie në Shkodër teksa po filmonte policinë dhe RENEA-n që po kryente kontrolle, ku ata i thanë të ndalonte filmimin dhe të largonte telefonin. – Në janar, gjatë një proteste jashtë selisë së Partisë Demokratike në Tiranë, më 8 janar 2022, gazetarët dhe ekipet e mediave u vunë në shënjestër të një makine policie që hidhte ujë me presion ndaj tyre dhe spërkaste me gaz lotsjellës. – Në janar, gazetari Ledio Guni u ndal nga policia teksa po filmonte dëbimin dhe shembjen e banesave të qytetarëve në lagjen “5 Maji” në Tiranë. – Në muajin shkurt, gazetaria Sonila Musai, u tërhoq zvarrë me dhunë nga policia teksa raportonte drejtpërdrejt për rezistencën e banorëve kundër prishjes së banesave të tyre në lagjen “5 Maji” në Tiranë. – Në muajin mars gazetari Sami Curri u shoqërua në Komisariatin e Bulqizës pas një proteste kundër rritjes së çmimit të naftës dhe ushqimeve. – Në mars, policia e shtetit sulmoi të paktën dy gazetarë gjatë demonstratave të organizuara në Tiranë dhe Durrës për rritjen e çmimit të ushqimit, karburantit dhe energjisë, ku një kameraman u godit dhe një gazetare femër u qëllua me grusht dhe shtyhej nga punonjësit e policisë, duke bërë që të dy gazetarët të përfundonin në urgjencën e spitalit. – Në maj, fotografi Gent Shkullaku u pengua nga policia të bënte foto të përlëshjeve mes hulgjanëve të Feyenoord dhe policisë, dhe iu mor aparatit fotografik, që më vonë iu kthye por me foto të fshira. – Në muajin gusht, në Korçë policia arrestoi një 62-vjeçar, pasi sulmoi fizikisht vajzën e tij dhe një gazetare të emisionit investigativ “Piranja”. – Në muajin nëntor, Adriatik Doçi, gazetar i Report TV dhe <a href="http://Shqiptarja.com">Shqiptarja.com</a> , u sulmua fizikisht nga persona të paidentifikuar.
<b>Vrasja e gazetarëve (në 15-20 vitet e fundit)</b> Llojet e vrasjeve mund të jenë shkëmbim zjarri, vrasje me paramendim, shpërthim bombe, rrahje për vdekje, etj.	0	

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<b>Kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve</b> Sulme faktike ndaj pronave të organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, sekuestrim pajisjes, deklarata agresive nga zyrtarë publikë, etj. Po ashtu, në kërcënime dhe sulme të tilla mund të jenë edhe ato të kategorive të mësipërme.	2	– Mediat kanë raportuar sulme kibernetike.

Isa Myzyraj i Ora News u përball me presion dhe kërcënime nga burime të shumta në lidhje me raportimin e tij për procesin e vetingut të Elizabeta Imerajt, ish-drejtuese e Prokurorisë së Tiranës.<sup>101</sup> Myzyraj kishte mbuluar seancat publike të proflilit të lartë në procesin e vetingut të Imerajt, si pjesë e një projekti të reformës në drejtësi në Shqipëri që synonte largimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar. Zonja Imeraj depozitoi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan një padi për shpifje ndaj Myzyrajt, duke e tërhequr gazetarin e ri në një betejë ligjore që po zgjat prej muajsh. Po ashtu, edhe gazetari i BIRN Edmond Hoxha ka raportuar se një noter publik ka nxjerrë të dhënat e tij personale për shkak të angazhimit të tij profesional si reporter në rastin e zonjës Elisabeta Imeraj, ish-drejtuese e Prokurorisë së Tiranës.<sup>102</sup> Rasti u raportua te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale por pa rezultate konkrete në fund.

Në një tjetër rast, një gazetar i BIRN u censuroi nga një gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër gjatë seancës gjyqësore për rastin “Dosja 184”. I pandehuri akuzoi gazetarin për përgjim dhe ka kërkuar që ai të përjashtohet nga seanca. I pandehuri akuzohet së bashku me ish-administratorin e Lurës për shpërdorim de tyre dhe përfshirje në një skemë të manipulimit të votës në vitin 2016.<sup>103</sup>

Gjatë një konference të improvizuar për shtyp më 30 mars 2022, kryeministri Rama i tha gazetares Ambrozia Meta se ajo kishte nevojë për “riedukim” dhe se ai do të refuzonte të merre pyetje prej saj për 60 ditë për shkak të asaj që ai e konsideronte si sjellje joprofesionale<sup>104</sup>. Gazetarja Meta i kishte bërë disa pyetje kryeministrit për çështje me interes publik, përfshirë edhe arrestimin e

një deputeti të Partisë Socialiste dhe një çështje korrupsioni të lidhur me inceneratorët në Shqipëri.

### Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Teksa raportonin jashtë perimetrit të kompanisë OBITAL në fshatin Sukth të Durrësit, ku pranë zonave të banuara u asgjësuan pula, persona që pretendonin se ishin përfaqësues të kompanisë thyen kamerën e kameramanit dhe kërcënuan me jetë gazetarin e emisionit investigativ Fiks Fare.<sup>105</sup>

### Sulme faktike ndaj gazetarëve

Në vitin 2022 gazetarët në Shqipëri kanë qenë objekt i formave të ndryshme të dhunës dhe ngacmimeve. Simon Shkreli, gazetari i TV Rozafa dhe ABC News, u ndalua nga një punonjës policie dhe u urdhërua të mos filmonte, ndërkohë që ishte me fëmijët e tij në qytetin e tij të lindjes në Shkodër.<sup>106</sup> Në 8 janar 2022, gazetarët dhe ekipet e mediave u vunë në shënjestër të një makine policie që hidhte ujë me presion ndaj tyre dhe spërkaste me gaz lotsjellës kundër njerëzve gjatë një proteste jashtë selisë së Partisë Demokratike në Tiranë.<sup>107</sup> Në 11 mars gazetari Sami Curri u shoqërua në Komisionin e Policisë Bulqizë. Ky aksion u zhvillua pas mbylljes së protestës së qytetarëve të organizuar në rrugën e Arbrit kundër rritjes së çmimit të naf-tës dhe ushqimeve.<sup>108</sup> Në 13 nëntor në Tiranë gazetari Adriatik Doçi u sulmua fizikisht nga persona të paidentifikuar,<sup>109</sup> dhe në 4 gusht, u arrestua një 62-vjeçar për sulm të ushtruar ndaj një gazetares që po ushtronte

101 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/other-attacks-to-journalist-isa-myzyraj-05-05-2022-tirana/>

102 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/other-threats-digital-harassment-for-journalist-edmond-hoxha-23-04-2022-tirana/>

103 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/direct-attack-on-birn-journalist-at-the-court-hearing/>

104 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/other-threats-to-journalists-ambrozia-meta-30-03-2022-tirana/>

105 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/fiks-fare-investigative-show-reporters-were-threatened/>

106 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/36328/>

107 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/albanian-journalists-hit-by-tear-gas-and-water-jets-while-covering-protest/>

108 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/journalist-sami-cami-was-escorted-after-the-protests-in-bulqiza/>

109 Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/actual-attack-on-journalist-adriatik-doci-13-11-2022-tirana/>

detyrën në Korçë.<sup>110</sup> Në një tjetër incident, punonjës të policisë i konfiskuan aparatin fotografik fotografit Gent Shkullaku gjatë përplasjeve me policisë dhe tifozëve të futbollit.<sup>111</sup> Gazetarët që mbulonin protestat kundër rritjes së kostove të ushqimit, karburantit dhe energjisë në qytete të shumta shqiptare u vunë në shënjestër të oficerëve të policisë, ku të paktën dy u sulmuan fizikisht në Tiranë dhe Durrës.<sup>112</sup> Në lagjen “5 Maji” në Tiranë, gazetari Ledio Guni u largua me forcë nga policia teksa filmonte shembjen e banesave të qytetarëve<sup>113</sup>. Edhe gazetaria Sonila Musai u tërhoq zvarrë nga policia teksa raportonte live rezistencën e banorëve kundër prishjes së shtëpive të tyre në lagjen “5 Maji” në Tiranë.<sup>114</sup>

### Numri dhe llojet e vrasjeve

Nuk ka.

### Numri dhe llojet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve

Në janar të vitit 2022, disa media online në Shqipëri, përfshirë [dosja.al](https://dosja.al), [syri.net](https://syri.net), [faktor.al](https://faktor.al), SportExpress, [Lapsi.al](https://lapsi.al), ndër të tjera, kanë raportuar se janë bërë objekt i sulmeve kibernetike që dyshohet se janë urdhëruar nga kryebashkiaku Erion Veliaj, pas publikimit të një regjistrimi audio të Veliajt ku përdorte kërcënime dhe gjuhë të neveritshme për të zgjedhur njeriun e tij në krye të organit drejtues të futbollit në vendi. Mediat pretendojnë se këto sulme kibernetike lidhen me kritikën e tyre të vazhdueshme ndaj qeverisë dhe kryebashkiakut Veliaj, i cili ka pranuar se regjistrimi audio është autentik, por nuk ka deklaruar në lidhje me sulme kibernetike, ndërkohë që Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists Network) ka bërë thirrje për nisjen e hetimeve.

## **C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve**

### A ka dispozita të posaçme në ligje ose mekanizma të tjerë që synojnë të mbështesin sigurinë e gazetarëve, në terren dhe online?

Siguria e gazetarëve si online ashtu edhe në terren në Shqipëri është përgjithësisht e garantuar, duke pasur parasysh garantitë kushtetuese, angazhimet në tërësi të Shqipërisë për të përmbushur standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Megjithatë, nuk ka ligje të posaçme që trajtojnë shqetësimet për sigurinë e tyre. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet anëtare, përfshirë edhe Shqipërinë, kanë detyrime negative dhe pozitive për mbrojtjen e gazetarëve. Kjo do të thotë se jo vetëm që ata duhet të mos bëjnë deklarata kërcënuese politike apo të nisnin procese gjyqësore kundër aktorëve të medias, por kanë për detyrë edhe të sigurohen aktivisht që t’u japin gazetarëve mbrojtjen e plotë ligjore dhe që gjyqësore t’u krijojnë një mjedis të përshtatshëm për punën e tyre në gazetari. Megjithatë, siç është raportuar edhe parë, vihet re se institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në terren. Kjo i vë gazetarët në rrezik të përballjes me sulme fizike, ngacmime online dhe kërcënime pa asnjë mbrojtje të vërtetë. Prandaj, edhe pse mund të ekzistojë kuadri ligjor, mungesa e zbatimit praktik i lë gazetarët të pambrojtur dhe të ekspozuar ndaj kërcënimeve.

### A ka dokumente (protokolle, rregulla të procedurave, etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore që u japin udhëzime shtesë forcave të armatosura dhe policisë për mënyrën se si të sillen me gazetarët?

Pavarësisht përpjekjeve për të ofruar trajnime dhe për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve publike, si, [p.sh.](https://p.sh), policia, në lidhje me trajtimin e gazetarëve dhe profesionistëve të medias, ka ende mungesë të protokolleve zyrtare të miratuara në të gjithë sistemin dhe që të jenë të institucionalizuara, koherente dhe sitematike. Kjo sjell paqartësi në trajtimin e gazetarëve dhe mungesë të llogaridhënies kur ndodhin incidente. Mungesa e protokolleve të qarta mund të kontribuojë edhe në një klimë mosndëshkimi, sepse ata që përdorin dhunë ose ngacmime ndaj gazetarëve mund të mos përballen me pasojat e duhura. Si rezultat, gazetarët vazhdojnë të përballen me rreziqe dhe kërcënime gjatë kryerjes së detyrës dhe me mjete të kufizuara për mbrojtje dhe drejtësi.

<sup>110</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/actual-attack-on-journalists-04-08-2022-devoll-korce/>

<sup>111</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/actual-attack-on-albanian-reporter-gent-shkullaku-24-05-2022-tirana/>

<sup>112</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/journalists-assaulted-by-police-during-demonstrations/>

<sup>113</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/albanian-journalist-ledio-guni-was-attacked-by-the-municipality-police-in-tirana/>

<sup>114</sup> Njoftimi <https://safejournalists.net/reports/sonila-musai-journalist-was-violently-dragged-away-by-police-while-on-duty/>

A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunën ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve dhe për pandëshkueshmërinë?

Në Shqipëri nuk mbledhen dhe as nuk publikohen të dhëna zyrtare për sulmet që u bëhen gazetarëve dhe për mosndëshkimin e këtyre sulmeve. Institucioneve shtetërore shpesh u mungojnë burimet dhe kapaciteti për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla, gjë që pengon përpjekjet për ta trajtuar këtë problematikë. Megjithatë, Këshilli i Evropës, Përgjigja e Shpejtë për Lirinë e Mediave dhe Rjeti i Gazetarëve të Sigurt janë mekanizmat kryesorë për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve të tilla. Nga ana tjetër, mungesa e protokolleve sistemore dhe të institucionalizuara dhe mekanizmeve të mbledhjes së të dhënave mbetet një problem madhor për garantimin e sigurisë së gazetarëve dhe trajtimin e sulmeve kundër tyre në Shqipëri.

Njësoj si në të kaluarën, të dhënat e pasqyruara në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme për gjendjen e kriminalitetit në vend gjatë vitit 2022, janë dëshmi e mungesës së të dhënave të veçuara dhe e një mekanizmi të pamjaftueshëm statistikor të këtij institucioni për të mbledhur dhe analizuar të dhëna për veprat penale me viktima gazetarë dhe punonjës të medias.<sup>115</sup> Për sa i përket të dhënave gjyqësore, mungesa e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve, përfshirë ato penale, e vështirëson gjurmimin e tyre në rastet kur ato janë dërguar në gjykatë dhe për rrjedhojë privon publikun nga aksesimi në të dhënat e unifikuara për të gjithë ecurinë e shqyrtimi penal dhe gjykimi i një çështjeje, faza ku ndodhet, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Të dhënat e Barometrit Kombëtar për Lirinë e Medias në Shqipëri, të publikuara nga KShH-ja në tetor 2022, tregojnë sërish se disa gjykata si ato të rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës dhe Tiranë vazhdojnë të referojnë problematik, ashtu si një vit më parë, fakti se për shkak të mënyrës së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, nuk mund të kryhet një përcaktim i profesionit të partisë dhe për rrjedhojë nuk mund të identifikoheshin problemet me gazetarët apo punonjësit e medias.<sup>116</sup>

A njihen sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet shtetërore si shkelje e lirisë së shprehjes dhe e Kodit Penal? A japin zyrtarët qeveritarë deklarata të qarta ku dënojnë sulmet ndaj gazetarëve?

Në vitin 2022, ndonëse vihet re përgjithësisht se sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve dënohen nga disa autoritete publike dhe konsiderohen si shkelje e lirisë së shprehjes, ka mungesë të veprimeve konkrete për t'i trajtuar këto probleme. Policia ka reaguar publikisht shumë më shpejt në sulmet ndaj gazetarëve, por hetimet e mëtejshme janë në një numër të kufizuar. Mungesa e përgjegjshmërisë dhe mosndëshkimi për ata që ushtrojnë dhunë ndaj gazetarëve mbetet një shqetësim serioz. Përveç kësaj, mungesa e mbledhjes sistemore dhe të institucionalizuar të të dhënave për sulmet kundër gazetarëve dëmton edhe më shumë aftësitë për t'i monitoruar dhe trajtuar në mënyrë efikase këto çështje.

A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve?

Në vitin 2022, ka pasur një rritje të bashkëpunimit mes institucioneve të pavarura dhe organizatave të gazetarëve për të trajtuar problemet e sigurisë së gazetarëve. Institucione të tilla si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri i të Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave kanë punuar ngushtë me organizatat e gazetarëve dhe mediave për të nxitur marrjen e masave për sigurinë e gazetarëve. Po ashtu, edhe Prokuroria e Përgjithshme dhe policia kanë treguar vullnet për të bashkëpunuar me organizatat e gazetarëve për trajtimin e çështjeve të sigurisë së këtyre të fundit. Gjithsesi, pavarësisht bashkëpunimeve të tilla, ka ende nevojë për protokolle sistemore dhe të institucionalizuara për të bërë të mundur sigurinë e gazetarëve. Përveç kësaj, monitorimi i MFRR-së për vitin 2022 argumenton se “është shqetësuese numri i incidenteve të dhunës policore ndaj gazetarëve, i cili ishte lidhur me 7 nga 17 shkeljet në 2022 të monitoruara prej MFRR”.<sup>117</sup>

115 Raporti vjetor Prokuroria e Përgjithshme, 2022, aksesuar në [https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE\\_T\\_PROKURORIT\\_T\\_P\\_RGJITHSH\\_M/](https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/)

116 Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 2022, aksesuar në <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shajper-Tetor-2022-KShH.pdf>, fq. 11

117 Media Freedom Rapid Response 2022 Albania, aksesuar më 30.03.2023 në adresën <https://www.mappingmediafreedom.org/wp-content/uploads/2023/02/MFRR-Monitoring-Report-2022.pdf>

Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili ishte rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike ndaj gazetarët?

---

Nuk ka raste zyrtare apo publike për mbikëqyrjen elektronike të gazetarëve për vitin 2022.

### **C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve**

---

**A ka njësi të posaçme brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile kushtuar hetimeve dhe ndjekjeve penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?**

---

Nuk ka njësi të posaçme në institucionet e sistemit të drejtësisë civile që të angazhohen me hetimet dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve. Kjo mungesë e njësive të posaçme mund të çojë në mungesë ekspertize për trajtimin e rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve dhe pengon nisjen e hetimeve efikase dhe të menjëhershme.

**A ofrojnë Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Brendshme burimet e nevojshme për të hetuar kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?**

---

Për qëllime të këtij raporti, nga intervistat arrihet në përfundimin se nuk ka asnjë dispozitë të veçantë për të siguruar burime të tjera që do të mbulonin dhe trajtonin hetimet për kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve. Megjithatë, ka një rritje të ndjeshmërisë ndaj rasteve të tilla. Agjencitë e zbatimit të ligjit janë mesatarisht të pajisura me njohuritë dhe burimet e nevojshme për të hetuar sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Fatkeqësisht, mungojnë protokolle të posaçme për hetime për të bërë të mundur zbulimin dhe ndjekjen efikase të agresionit dhe dhunës ndaj gazetarëve.

**A bëhen me shpejtësi, paanshmëri dhe efikasitet hetime për krimet ndaj gazetarëve, përfshirë këtu kërcënimet dhe frikësimet ndaj tyre?**

---

Në raport evidentohet se gjatë pesë viteve të fundit, ka pasur raste të bujshme të sulmeve fizike kundër gazetarëve, raste që nuk janë hetuar siç duhet. Mungesa

e dispozitave të qarta në Kodin Penal për të garantuar mbrojtje të posaçme për gazetarët në rastet e dhunës apo sulmeve të kryera ndaj tyre për shkak të detyrës ka krijuar një mjedis ku prokurorët janë përherë e më pak të prirur t'i hetojnë këto krime me përparësi. Hetimi i motiveve të këtyre veprave penale është i dobët ose mungon dhe për rrjedhojë këto motive vdesin në një meshtje institucionale që nuk garanton të paktën të vërtetën para publikut dhe as dënimin e plotë për viktimat e tyre.

Është shumë e vështirë të merren informacione për hetimet në proces për shkak të parimit të fshehtësisë që drejton hetimet. Megjithatë, të dhënat e mbledhura për këtë raport sugjerojnë se hetimeve për sulmet aktuale kundër gazetarëve nuk i jepet prioriteti më i lartë dhe se jo gjithmonë sigurohen prova cilësore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka vënë në dukje përpjekjet për zvarritjen e hetimeve në rastet e përfaqësuar nga avokatët e tij, si sulmi fizik ndaj Xh.M., gazetare e Ora News, e shoqëruar nga policia gjatë një demonstrate për vrasjen e Klodian Rashës nga një oficer policie në dhjetor 2020 dhe rasti i M.K., një praktikante që bëri stazhin në një stacion televiziv lokal në Gjirokastër e cila akuzoi për ngacmim seksual pronarin e medias.<sup>118</sup> Të dyja rastet vijojnë të hetohen prej më shumë se 2 vitesh në fazën e prokurorisë, ndërsa çështja e M.K është kthyer disa herë nga gjyqtari i hetimeve paraprake për hetime të mëtejshme në prokurori, duke mos pranuar kërkesën e këtij të fundit dhe të përsëritur të prokurorisë. të pushojë çështjen penale. Raportet tregojnë se janë shkelur afatet procedurale dhe burimet dhe kapacitetet e policisë janë të pakta, duke penguar më tej hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Si rezultat, hetimi i sulmeve ndaj gazetarëve nuk është gjithmonë prioritet.

**A u ofrohen gazetarëve masa mbrojtjeje kur e kërkojnë ata në përgjigje të kërcënimeve të besueshme për sigurinë e tyre fizike?**

---

Mbrojtja e gazetarëve nga ngacmimi trajtohet në ligje të ndryshme që e përcaktojnë atë në mënyrë të ngushtë ose shumë të përgjithësuar, siç është rasti i ne-neve 237 dhe 238 të Kodit Penal që u analizuan më herët në këtë raport, të cilat parashikojnë goditje ose kërcënim për shkak të detyrës. Neni 108/a i Kodit Penal, për shembull, parashikon mbrojtje vetëm kundër ngacmimeve seksuale. Këtu përfshihet çdo formë e sjelljes seksuale “që cenonë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose ofendues, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.” Përcaktimi “me çdo mjet ose formë” përfshin

<sup>118</sup> Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor – Raporti për Shqipërinë për 2021: <https://safejournalists.net/resources/western-balkans-journalists-safety-index-narrative-report-albania-2021/>

edhe ngacmimin seksual online. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose ndaj fëmijëve, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Neni 32/a i Kodit të Punës jep një përkufizim të plotë të ngacmimit në marrëdhëniet e punës. Ai kërkon që punëdhënësit të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ngacmimet seksuale dhe morale nga punonjësit, duke përfshirë çdo formë ngacmimi që degradon kushtet e punës dhe dëmton shëndetin fizik dhe mendor të punonjësit. Për më tepër, neni 3, pika 5 e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashikon mbrojtje nga “ngacmimi” me bazë diskriminuese. Një ngacmim i tillë ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues ose fyes. Institucionet shtetërore në Shqipëri nuk i kanë ngritur ende mekanizmat efikasë që të jenë të krijuar posaçërisht për gazetarët dhe stafin e medias për t’u ofruar atyre masa mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar. Gazetarëve nuk u ofrohet asnjë shërbim i specializuar ligjor. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në terren. Mekanizmat e mbrojtjes dhe sigurisë së viktimave të parashikuara në ligj nuk janë të përshtatur për gazetarët dhe viktimat mund të mos përfitojnë nga mbrojtja e mjaftueshme apo nga ndonjë alternativë tjetër për ndryshim vendbanimi si masë mbrojtëse.

**Në rast vendimi të formës së prerë, ndëshkohen vetëm shkelësit apo edhe nxitësit/porositësit?**

Në përgjithësi, në vendimet e formës së prerë jepen sanksione që i vendosen vetëm shkelësve.

**A organizojnë institucionet trajnime të përshtatshme për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të gazetarëve? A i organizojnë institucionet këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?**

Me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë, janë organizuar trajnime, por ka nevojë për një qasje më sistematike drejt ndërtimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit. [P.sh.](#), në Raportin Vjetor për Kriminalitetin e Prokurorisë së Përgjithshme, përmendet se në datat 23-24 mars 2022, një prokuror ka ndjekur trajnimin “Siguria e Gazetarëve”. Këto trajnime duhet të jenë pjesë e moduleve fillestare dhe të vazhdueshme për prokurorët në Shkollën e Magjistraturës.



Tabela 3: Përmbledhje e gjendjes së disa prej rasteve më të rënda të sulmeve ndaj gazetarëve në tre vitet e fundit

Vit	2020.	2021.	2022.
<b>Rast</b>			
	<p>Pas shembjes së Teatrit Kombëtar më 17.05.2020, redaktori i <a href="#">Politiko.al</a>, Alfred Lela, u arrestua me dhunë teksa raportonte nga protestat kundër prishjes së teatrit.</p>	<p>Çështja u pushua.</p>	
	<p>Në 30 tetor 2020, pak pas mesnatës, shtëpinë e Eldion Ndreka, reporterit dhe gazetarit lokal të News24 e tronditi një shpërthim i fuqishëm. Në momentin e shpërthimit, Ndreka ishte në shtëpi me familjen e tij. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale.</p>		
	<p>Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, pronarë dhe redaktorë të portalit <a href="#">lapsi.al</a>, u ndaluan për t'u pyetur nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) si pjesë e një hetimi të hapur zyrtarisht për rrjedhjen e të dhënave personale të 910,000 mijë qytetarëve – në prill 2021.</p>	<p>Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) reagoi menjëherë duke kërkuar pezullimin e masës me arsyetimin e lirisë së fjalës së gazetarit dhe mbrojtjes së burimeve konfidenciale. Në fillim të majit 2021, gjyqësori shqiptar mori parasysh kërkesën e GJEDNJ.</p>	
	<p>Një punonjës policie vuri në rrezik jetën e dy gazetarëve (Anila Hoxha nga televizioni Top Channel dhe Endri Aga, pjesëtar i ekipit të xhirimit të televizionit A2CNN) duke i shtyrë në buzë të humnerës teksa raportonin për një vrasje në zonën e Qafë Mollës.</p>	<p>Ngjarja u raportua menjëherë tek autoritetet. Më vonë po atë ditë, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të Ministrisë së Brendshme konfirmoi se kishte nisur hetimet në lidhje me dhunën e ushtruar nga një punonjës policie ndaj gazetares Hoxha dhe kolegut të saj. Drejtori i Drejtorisë së Policisë së Tiranës reagoi menjëherë duke pezulluar nga puna punonjësën e policisë ndaj të cilit ishte bërë ankesa nga gazetarja Anila Hoxha dhe kolegu i saj.</p>	
	<p>Reporterit i Fax News, Ledio Guni, u sulmua fizikisht në Tiranë më 11 tetor 2021, teksa raportonte për një grindje mes mësuesve dhe familjeve të nxënësve në lokalit pranë Gjimnazit "Çajupi". Ai ishte në detyrë duke raportuar drejtpërdrejt nga vendi i ngjarjes, por teksa filmonte me aparatit e tij nga makina e medias që ai përfaqësonte, një burrë e sulmoi fizikisht duke e gjuajtur me karrige.</p>		
	<p>Në muajin shkurt 2022, gazetarja Sonila Musai, u tërhoq zvarrë me dhunë nga policia teksa raportonte drejtpërdrejt për rezistencën e banorëve kundër prishjes së banesave të tyre në lagjen "5 Maji" në Tiranë.</p>		<p>U regjistrua procedimi penal nr. 2230/2022, për të cilën në 22 shkurt 2022 Prokuroria vendosi të mos nisë ndjekje penale.</p>

# Përfundimet dhe rekomandimet

## PËRFUNDIME

Liria e medias dhe siguria e gazetarëve në Shqipëri po përballen me sfida të vazhdueshme, duke ndikuar shumë në aftësinë e gazetarëve për të punuar në mënyrë të pavarur, larg frikës nga hakmarrja, kërcënimet, presionet dhe ngacmimet. Pavarësisht garancive që përcaktohen në Kushtetutë për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes, vështirësitë strukturore vazhdojnë të bëhen pengesë që mediat të jenë të afta për të vepruar lirisht dhe në mënyrë të pavarur. Pronësia e medias mbetet e përqendruar në pak duar dhe interesat e fuqishme ekonomike dhe politike ushtrojnë kontroll tejet të madh në mjedisin e mediave. Kjo ka sjell si rezultat një numër të kufizuar zërash, mungesë të transparencës dhe rënie të besimit tek media.

Edhe për vitin 2022 ka vazhduar të rritet përqendrimi i informacionit publik, ku si propaganda e qeverisë ashtu edhe fushatat disinformuese të opozitës kanë dëmtuar më tej kapacitetin e mediave profesionale për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe të saktë. Aksesi në informacion është i kufizuar dhe gazetaria investigative, e cila luan një rol vendimtar në zbulimin e korrupsionit dhe nxitjen e kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë, përballat me vështirësi të mëdha. Ndryshimet e propozuara në ligjin për të drejtën e informimit në vitin 2022 u kritikuan ashpër, sepse nuk trajtonin plotësisht kërkesat e organizatave të mediave dhe grupeve të shoqërisë civile.

Cilësia e përmbajtjes së raportimeve u përkeqësua me rritjen e vetë-censurës nga gazetarët dhe tkurrjes së të hapësirës për gazetari të pavarur, kritike dhe investigative. Siguria e gazetarëve kërcënohet nga dobësitë dhe mangësitë në zbatimin e Kodit të

Punës, nga sfidat me motive gjinore në sektorin e medias, nga shqetësimet e sigurisë dixhitale, disinformimi me bazë gjinore si dhe nga fushatat dhe presionet e përgjithshme kundër medias. Gazetarët që punojnë në mediat lokale, gazetarët e rinj dhe gazetarë femra përballen me më shumë vështirësi.

Po ashtu, ka shqetësime në lidhje me sigurinë e gazetarëve në Shqipëri, veçanërisht kur bëhet fjalë për presione dhe intimidim. Edhe pse numri i sulmeve ndaj sigurisë fizike dhe jetës së gazetarëve dhe të afërmeve të tyre mbetet i kufizuar, ka pasur 18 sulme (12 kundër gazetarëve meshkuj dhe 6 kundër gazetarëve femra) të regjistruara për vitin 2022. Pavarësisht ndërgjegjësimit të përgjithshëm, agjencitë e zbatimit të ligjit nuk janë plotësisht të pajisura me njohuritë, kapacitetet dhe burimet për të hetuar plotësisht, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe objektive sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Hetimet janë shpesh të ngadalta, me një kohëzgjatje të jashtëzakonshme që dëmton efikasitetin e tyre, me transparencë të kufizuar në procesin e hetimit për shkak të fshehtësisë së hetimit. Mungesa e një mbrojtjeje të posaçme ligjore në kodin penal për viktimat, punonjësit e medias, të cilët goditen ose kërcënohen për shkak të detyrës, duket se krijon një zonë rehatie për autoritetet që të mos hetojnë motivet e këtyre krimeve, gjë që sjell edhe pandëshkueshmërinë e Shqipërisë. Legjislacioni nuk ofron një përkufizim gjithëpërfshirës të ngacmimit, duke përfshirë ngacmimin në internet, dhe autoritetet shtetërore kanë njohuri, kompetenca, burime dhe procedura të kufizuara për mbrojtjen e gazetarëve nga ngacmimet në internet.

Në Shqipëri mjedisi për gazetari cilësorë, të pavarur dhe kritike në interes të publikut mbetet mjaft i kërcënuar për shkak të vështirësive të vazhdueshme. Këto vështirësi burojnë nga një numër i madh problemesh strukturore, përfshirë këtu marrëdhëniet simbiotike mes politikës, biznesit dhe medias, përqendrimin e pronësisë së mediave në pak duar, mungesën e transparencës për burimet e financimit, përdorimin e mediave për shantazh, konfliktin e interesave, pluralizmin e pakët mediatik, aksesin e pamjaftueshëm në informacion, uljen e cilësisë së përmbajtjes të raportimeve mediatike, rritjen e informacionit të rremë dhe çorientues dhe kushteve të këqija të punës dhe të drejtave të punës. Për të krijuar një mjedis të favorshëm ku gazetaria në Shqipëri të mund të lulëzojë, nevojiten urgjentisht përmirësime të mëdha në këto fusha nga aktorët përkatës shtetërorë dhe joshetërorë. Gjithashtu, vetë-rregullimi i medias është me rëndësi të jashtëzakonshme ashtu si edhe respektimi i kodit etik të gazetarisë. Autoritetet në Shqipëri duhet të ndër marrin hapa konkretë për të trajtuar këto sfida duke krijuar mekanizma efektivë posaçërisht për gazetarët dhe stafin e medias për t'u siguruar atyre masa mbrojtëse kur ata kërcënohen.

## REKOMANDIME

Duke pasur parasysh se situata e mediave nuk është përmirësuar në vitin 2022, pjesa më e madhe e rekomandimeve nga raporti i vitit të kaluar janë ende të vlefshme. Rekomandimet kryesore për politikëbërësit për secilën fushë janë si më poshtë:

### PËR MBROJTJEN LIGJORE

- Të sigurohet zbatimi i plotë i garancive ligjore për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, përfshirë edhe atë në internet, si dhe të ofrohet një mjedis mediatik mundësues në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Të sigurohet transparencë e plotë dhe proaktive e reklamave publike dhe shtetërore.
- Të përmirësohet transparenca proaktive për pronësinë e mediave dhe burimet e financimit për të shmangur konfliktin e interesave.
- Të mbështetet krijimi dhe forcimi i mekanizmave vetërregullues me kapacitete ekzekutive.
- Të ndryshohet Kodi Zgjedhor për të garantuar mundësi të barabarta për të gjitha partitë garuese për akses në media (audiovizive dhe online), përfshirë këtu edhe hapësirën e reklamave; po ashtu, të merret parasysh edhe mundësia e ndarjes së një sasive të barabartë kohe falas për të kandidatët gjatë fushatës.
- Të ndryshohet ligji për të bërë të mundur që mediat të kenë mundësi në mënyrë të pavarur të mbulojnë aktivitetet e kandidatëve në fushatat zgjedhore me synim kufizimin e përdorimit të materialeve të gatshme të prodhuara nga partitë për edicionet e lajmeve sipas edhe rekomandimeve të OSBE/ODHIR.
- Kodi Penal do të rishikohet për të siguruar mbrojtje të veçantë ligjore për punonjësit e medias, të cilët goditen ose kërcënohen për shkak të detyrës.
- Të bëhet e mundur që agjencitë e zbatimit të ligjit të kenë trajnimin e duhur për të hetuar në mënyrë sistematike rastet e shantazheve ndaj mediave dhe të kenë burimet e nevojshme për të kryer hetime të plota dhe të paanshme.
- T'u jepet mbështetje ligjore dhe financiare sinjalizuese që bëhen objekt hakmarrjeje nga punëdhënësit e tyre apo nga aktorë të tjerë të pushtetshëm në industrinë e medias.

### PËR POZICIONIN E GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

- Të sigurohet pavarësia dhe përmirësohet transparenca dhe llogaridhënia e autoritetit rregullator të

mediave me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së mediave.

- Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik në shërbim të publikut për të bërë të mundur raportim të paanshëm të lajmeve dhe për të parandaluar ndikimin politik.
- Të forcohet zbatimi i vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit/Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.
- Të mbështetet dhe të jepen stimuj për barazinë gjinore në redaksi me qëllim nxitjen e diversitetit dhe mundësive për të gjithë.
- Zhvillimi i kurrikulave speciale për sigurinë e gazetarëve, si pjesë e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm që Shkolla e Magjistraturës duhet të kryejë me gjyqtarët dhe prokurorët, ku inkurajohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe vendore për çështjet e gazetarisë.
- Të mbështetet dhe të përmirësohet raportimi për diversitetin me qëllim promovimin e një industrie mediatike gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese.

#### PËR SIGURINË E GAZETARËVE

- Të zbatohet një politikë e tolerancës zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, si dhe për kërcënimet ndaj medias, përfshirë këtu edhe në debatin politik.
- Të ofrohet mbrojtje dhe hapësirë e sigurt për gazetarët.

- Të zbatohet Kodi i Punës dhe të forcohet mbrojtja e të drejtave të punës, sigurimeve shoqërore dhe të drejtave sociale për gazetarët në Shqipëri edhe nëpërmjet krijimit të një sindikate gazetarësh dhe forcimit të shoqatave të gazetarëve.
- Të mblidhen dhe botohen të dhëna të rregullta për sigurinë e gazetarëve, për kushtet e punës dhe çështje të tjera të lidhura me to.
- Të ndiqet çështja e sigurisë digjitale të gazetarëve dhe të rriten kapacitetet e institucioneve publike për trajtimin e problemeve të sigurisë digjitale për gazetarët dhe profesionistët e mediave.

Rekomandimet kryesore për shoqatat e gazetarëve:

#### PËR SHOQATAT E GAZETARËVE

- Të krijohet një platformë e përbashkët e shoqatave të gazetarëve, mediave dhe atyre që ofrojnë mbështetje ligjore dhe profesionale në bashkëpunim me nismat ekzistuese për gazetarët dhe redaktorët, siguria e të cilëve është nën kërcënim.
- Të mbështetet gazetaria fakt-verifikuese dhe ajo investigative, por të jepen edhe mesazhe të përgatitura mirë dhe qartë përmes të cilave qytetarët të kuptojnë proceset dhe marrëdhëniet dhe jo thjesht vetëm faktet e paraqitura.
- Të mbështeten gazetarët femra, gazetarët e rinj dhe gazetarët që punojnë në mediat lokale.
- Të ofrohet ngritja e kapaciteteve, të mobilizohen burimet dhe të mblidhen fonde për shoqatat e gazetarëve.

- Të krijohen dhe konsolidohen mekanizmat e vetë-rregullimit me kapacitete ekzekutive.
  - Të rritet ndërgjegjësimi, mbështetja dhe fuqizimi i gazetarëve që ende nuk kanë vullnetin të raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre të punës nga frika e humbjes së vendit të punës dhe për shkak të mungesës së besimit të sistemi i drejtësisë.
  - Të rritet solidaritetit mes shoqatave të gazetarëve për çdo rast censure ose sulmi ndaj anëtarëve dhe/ose përfaqësuesve të mediave për shkak të profesionit.
  - Është me shumë rëndësi që të mos normalizohet apo pranohet asnjë formë e praktikave shantazhuese në sektorin e medias. Shoqatat e gazetarëve, OSHC-të dhe grupet e tjera të interesit të mbajnë një qëndrim të fortë kundër praktikave të tilla dhe të punojnë që ato të mos tolerohen apo mundësohen në asnjë mënyrë. Kjo lidhet me zbatimin e kodeve strikte të etikës dhe të sjelljes për gazetarët dhe mediat, ofrimin e edukimit dhe trajnimit për praktikën e gazetarisë etike dhe krijimin e mekanizmave për të hetuar dhe trajtuar çdo akuzë për shantazh ose forma të tjera të sjelljes joetike.
- dhe konsultimin e vërtetë me aktorët përkatës si organizatat e medias, shoqëri të civile dhe grupet e tjera të interesit. Është e rëndësishme të sigurohet transparencë dhe një qasje pjesëmarrëse gjatë gjithë procesit për të krijuar besim dhe vërtetësi tek procesi.
  - Të bëhen përpjekje për të promovuar pluralizmin mediatik dhe diversitetin e pikëpamjeve, përfshirë këtu edhe masat që luftojnë përqendrimin e pronësisë së mediave në pak duar dhe për mbështetjen e zhvillimit të mediave të pavarura dhe alternative.
  - Të forcohet mbrojtja ligjore për gazetarët dhe lirinë e shprehjes, përfshirë edhe masat për të përmirësuar aksesin në informacion, për të mbrojtur sinjalizuesit dhe për të luftuar disinformimin dhe propagandën.
  - Të trajtohen çështje që lidhen me profesionalizmin e medias, si përmirësimi i standardeve dhe etikës së gazetarëve, rritja e mundësive të trajnimit dhe zhvillimit për gazetarët dhe promovimi i edukimit mediatik dhe informativ në publik.
  - Të vazhdohet me tej me dixhitalizimin e sektorit të medias, ku të përfshihet zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave, me forcimin e sigurisë dixhitale, me luftën kundër disinformimit me bazë gjinore dhe gjetjen e metodave novatore për financimin e qëndrueshëm të mediave.
  - Të vazhdohet me investimet në programet e mediave dhe të edukimit për informimin.

Rekomandimet kryesore për aktorët ndërkombëtarë:

#### PËR AKTORËT NDËRKOMBËTARË

- Përpjekjet për përmirësimin e lirisë së medias në Shqipëri duhet të kenë si përparësi gjithëpërfshirjen, pranimin dhe përvetësimin nga vetë aktorët





